

JURISPRUDENCA E GJYKATËS EVROPIANE
TË TË DREJTAVE TË NJERIUT NË LIDHJE
ME SHQIPËRINË DERI NË FUND TË 2016-ËS

THE CASE LAW OF THE EUROPEAN COURT
OF HUMAN RIGHTS WITH RESPECT TO
ALBANIA UP UNTIL THE END OF 2016



The AIRE Centre
Advice on Individual Rights in Europe

JURISPRUDENCA E GJYKATËS EVROPIANE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT NË LIDHJE ME SHQIPËRINË DERI NË FUND TË 2016-ËS

THE CASE LAW OF THE EUROPEAN COURT OF HUMAN RIGHTS WITH RESPECT TO ALBANIA UP UNTIL THE END OF 2016



The AIRE Centre
Advice on Individual Rights in Europe

Përgatitur nga Qendra AIRE

Prepared by the AIRE centre



Foreign &
Commonwealth
Office

The preparation of this publication has been supported by the UK Foreign and Commonwealth Office. Views presented in the publication do not necessarily reflect the official position of the Foreign and Commonwealth Office.



Regional Cooperation Council

This document has been produced with the financial assistance of the Regional Cooperation Council. The views expressed herein can in no way be taken to reflect the official opinion of the Regional Cooperation Council.

／ PËRMBAJTJA ／


Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në lidhje me Shqipërinë deri në fund të 2016-ës

Neni 2.....	7
Neni 3.....	7
Neni 5.....	8
Neni 6 dhe neni 1 i Protokollit nr. 1	9
Neni 7.....	13
Neni 8.....	13
Neni 13.....	14
Protokolli Nr. 7, neni 4	14
Protokolli Nr. 13, neni 1	14
Neni 34	14
Neni 37	14
Neni 80	14
Neni 46.....	15
Jurisprudenca e ndarë në nene.....	17

／ CONTENT ／

The case law of the European Court of Human Rights with respect to Albania up until the end of 2016

Article 2.....	35
Article 3.....	35
Article 5.....	36
Article 6 and Article 1 of Protocol No. 1	37
Article 7.....	41
Article 8.....	41
Article 13.....	42
Protocol No. 7, Article 4.....	42
Protocol No. 13, Article 1	42
Article 34.....	42
Article 37.....	42
Article 80.....	42
Article 46.....	42
Jurisprudence broken down by Article.....	45



JURISPRUDENCA E GJYKATËS
EVROPIANE TË TË DREJTAVE
TË NJERIUT NË LIDHJE ME
SHQIPËRINË DERI NË
FUND TË 2016-ËS

Republika e Shqipërisë

Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) në lidhje me Shqipërinë

Ky dokument përmbledh vendimet e marra nga GJEDNJ në lidhje me Republikën e Shqipërisë, që nga koha e ratifikimit të Konventës Evropiane më 2 tetor 1996. Deri më 31 dhjetor 2016, Gjykata ka vendosur kundër Shqipërisë 70 vendime themeli dhe 62 vendime mbi pranueshmërinë.¹

Ky dokument përbëhet nga dy pjesë. Në pjesën e parë të tij përshkruhen në mënyrë të përmbledhur llojet e çështjeve mbi të cilat ka vendosur Gjykata. Pjesa e dytë përmban një tabelë të ndarë në nene, ku për secilin nen listohen rastet e gjykuara me një përshkrim të shkurtër të çështjeve ligjore të ngritura në secilin rast. Disa çështje shfaqen më shumë se një herë nën të njëjtin nen, për shkak se Gjykata një herë ka vendosur për shkelje dhe një herë jo.

Neni 2

Janë dhënë dy vendime në lidhje me nenin 2, kundër Shqipërisë, *Ceka*² dhe *Rrapo*³. Rasti i parë u çregjistrua, pasi Gjykata vendosi se kërkuarisi kishte marrë zgjidhjen e plotë sipas së drejtës së brendshme, duke qenë se Shteti kishte pranuar qartazi shkeljen dhe kishte ofruar dëmshpërblimin e përshtatshëm.⁴ Në rastin e dytë, i cili kishte të bënte me ekstradimin e kërkuarist, nuk u konstatua shkelje,⁵ pasi në notën diplomatike jepeshin garanci të mjaftueshme se nuk do të kishte cenim të së drejtës së jetës pas ekstradimit.

Neni 3

Janë dhënë pesë vendime për pranueshmërinë dhe themelin në lidhje me nenin 3. Njëri prej rasteve u çregjistrua pasi Gjykata vendosi se kërkuarisi kishin marrë zgjidhjen e plotë sipas së drejtës së brendshme, duke qenë se Shteti kishte pranuar qartazi shkeljen dhe kishte ofruar dëmshpërblimin e përshtatshëm.⁶

Në tri raste, që kishin të bënin me kushtet në të cilat mbaheshin të paraburgosurit u vërejtën shkelje. Dy prej tyre, *Groni dhe Dybeku*⁷ kishin të bënin me shëndetin mendor. Në lidhje me to, Gjykata vendosi se mungesa e trajtimit të duhur mjekësor në burg ndërkohë që kërkuarisi ishin të sëmurë, përbënte shkelje të nenit 3. Në rastin *Dybeku*, Gjykata Evropiane, në bazë të nenit 46 të Konventës, përcaktoi masat e nevojshme që duhet të merrnin autoritetet shqiptare, si një çështje urgjente, për të siguruar kushte të përshtatshme ndalimi dhe trajtimi mjekësor, veçanërisht për të burgosurit, të cilët kanë nevojë për kujdes të specializuar për shkak të gjendjes së tyre shëndetësore.

Në vendimet e saj Gjykata ka kritikuar në veçanti: vonesat në garantimin e kujdesit shëndetësor dhe mungesën e ndihmës

1 AIRE Centre falënderon MSc. Ina Xhepa, Drejtore Ekzekutive e Qendrës Evropiane në Shqipëri, për ndihmën dhe ekspertizën e dhënë në përgatitjen e këtij publikimi.

2 *Ceka k. Shqipërisë*, vendim i 23 tetorit 2012

3 *Rrapo k. Shqipërisë*, vendim i 25 shtatorit 2012

4 *Ceka k. Shqipërisë*, vendim i 23 tetorit 2012

5 *Rrapo k. Shqipërisë*, vendim i 25 shtatorit 2012

6 *Ceka k. Shqipërisë*, vendim i 23 tetorit 2012

7 *Groni k. Shqipërisë*, vendim i 7 korrikut 2009; *Dybeku k. Shqipërisë*, vendim i 18 dhjetorit 2007

së duhur mjekësore (përfshirë ambientet dhe ilaçet përkatëse); papajtueshmërinë e kushteve të burgimit me gjendjen shëndetësore, p.sh. vendosja e një të burgosuri i cili vuan nga probleme të shëndetit mendor në të njëjtin vend me të burgosurit e shëndetshëm; mungesa e procedurave të brendshme efektive, p.sh. mosrespektimi i ankesave për mosdhënien e trajtimit të duhur mjekësor dhe në rastin *Groni*, mohimi i kontaktit me përfaqësuesit e tij (për shkak se mbahej i ndaluar sipas regjimit të sigurisë së lartë), pavarësisht rrezikut të një urgjence mjekësore.

Rasti *Groni* ngrinte çështjen e paligjshmërisë së ndalimit të kërkuesit për më shumë se 18 muaj, urdhëruar nga Gjykata e Lartë në bazë të Konventës Evropiane për Vlefshmërinë Ndërkombëtare të Gjyqimeve Penale dhe Konventës për Transferimin e Personave të Dënuar, pavarësisht faktit që ende nuk kishin hyrë në fuqi në Shqipëri⁸ (shkelje të nenit 5 § 1), si edhe vonesës të pajustificuar për të vepruar në përputhje me masën e ndërmjetme të Gjykatës Evropiane për transferimin e kërkuesit në një spital civil (shkelje të nenit 34).

Në rastin *Kaçiu dhe Kotorri*⁹, Gjykata pranoi më tej se dhuna fizike ndaj njërit prej kërkuesve ishte e një ashpërsie të tillë, që dërgimi i tij në sallën e gjyqimit ishte i nevojshëm të bëhej nga oficerë të policisë. Kërkuesit kishin shenja të dukshme, që dëshmonin për një trajtim të tillë, i cili ishte ushtruar qëllimisht nga punonjësit e policisë gjatë marrjes së tyre në pyetje. Rrahja e njërit prej kërkuesve kishte ngjallur tek ai ndjenjat e frikës dhe ankthit, duke e fyer, poshtëruar e thyer rezistencën e tij fizike dhe morale me qëllim për ta detyruar të rrëfehej.

Gjykata më tej theksoi se, rendi i ngjarjeve tregoi se me shumë mundësi, kërkuesi i ishte nënshtruar një trajtimi të tillë të dënueshëm prej oficerëve të policisë për një periudhë të konsiderueshme kohore dhe si pasojë kishte dhënë deklaratat ku inkriminonte veten e tij dhe kërkuesin e dytë, duke shpresuar t'i jepte fund sa më parë vuajtjeve mendore dhe fizike. Trajtimi në fjalë ishte i një niveli të tillë ashpërsie, që të arrinte në torturë brenda kuptimit të nenit 3 dhe Gjykata u shpreh se ka pasur shkelje të nenit 3 në të dy aspektet e tij, material dhe procedural. Ky ishte vendimi i parë kundër Shqipërisë i një rëndësie të tillë. Shkeljet e të tjera që u gjetën në këtë rast siç përmendet në grupin e rasteve *Caka*: përdorimi i pohimeve inkriminuese të marra si rezultat i torturës në procedimet kundër kërkuesve dhe mungesa e kontaktimit të një avokati gjatë arrestit policor (shkelje të neneve 6§1, 6§3c dhe 6§3); dhe kohëzgjatja e procedurës përkatëse përtej afatit të arsyeshëm (shkelje e nenit 6§1)10.

Neni 5

Në lidhje me nenin 5 janë dhënë dy vendime, ku është konstatuar shkelje për të dyja rastet. Në vendimin *Delijorgji*¹¹, Gjykata Evropiane gjeti shkelje të neneve 5§1 dhe 5§4 për shkak të kohëzgjatjes së paraburgimit «në pritje të vendimit», si edhe periudhës së gjatë që u desh për të shqyrtuar një kërkesë për lirim. Bazuar në nenin 5§1, kërkuesi pretendonte se periudha e paraburgimit «në pritje të vendimit» kishte skaduar dhe nëse ishte kështu, ndalimi i tij vazhdonte të ishte i paligjshëm. Gjykata Evropiane konstatoi se gjykatat vendase kishin interpretuar në mënyrë kontradiktore nenin 263 § 2 të Kodit të Procedurës Penale, i cili nuk ishte i qartë dhe i parashikueshëm në aplikimin e tij për qëllim të llogaritjes së kohëzgjatjes së paraburgimit «në pritje të vendimit». Për më tepër, asnjë arsye nuk ishte dhënë për vendosjen e kërkuesit në arrest shtëpie, kështu që ai ishte mbajtur në një gjendje pasigurie, përsa i përket motiveve të paraburgimit të tij të vazhdueshëm.

Për qëllimet e nenit 5§4, Gjykata u shpreh se në rastet kur pritet një vendim, kërkohet një vendim i shpejtë që përcakton ligjshmërinë e paraburgimit, pasi i pandehuri duhet të përfitojë plotësisht nga parimi i prezumimit të pafajësisë. Gjykata kritikoi kohën e tepërt të marrë nga gjykatat vendase për shqyrtimin e kërkesës për lirim, si dhe vonesat e shkaktuara nga gjykatat më të ulëta, të cilat kishin dështuar në zbatimin e vendimit të Gjykatës së Lartë në këtë drejtim.

8 *Groni k. Shqipërisë*, vendim i 7 korrikut 2009

9 *Kaçiu dhe Kotorri k. Shqipërisë*, vendim i 23 tetorit 2012.

10 *Kaçiu dhe Kotorri k. Shqipërisë*, vendim i 23 tetorit 2012.

11 *Delijorgji kundër Shqipërisë*, vendim i 28 prillit 2015

Neni 6 dhe neni 1 i Protokollit nr. 1

Në total janë dhënë 36 vendime në lidhje me nenin 6. Shkelje u gjetën në 33 çështje. 15 vendime janë dhënë në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1, duke konstatuar shkelje tek të gjitha.

Neni 6§1 dhe §3: e drejta për një proces të rregullt

Në rastet e quajtura grupi i rasteve *Caka*, Gjykata Evropiane konstatoi shkelje të Konventës si rrjedhojë e proceseve penale të padrejta, që çuan në dënimin e kërkuësve me burgim. Ndërsa përsa i përket vendimit të fundit *Kaçiu dhe Kotorri*, Gjykata konstatoi shkelje për shkak të përdorimit të provave të marra si rezultat i torturës, keqtrajtimit nga ana e policisë dhe mungesës së aksesit tek një avokat gjatë periudhës së ndalimit.

Në lidhje me padrejtësinë e procedimeve, Gjykata vuri në dukje mangësitë e mëposhtme:

- në rastin *Caka*¹² - dështimi për të siguruar dhënien e dëshmisë në gjykimin e kërkuësit nga dëshmitarë të caktuar dhe dështimi i Gjykatës së Shkallës së Parë për të marrë parasysh siç duhej dëshmitë e katër dëshmitarëve në favor të kërkuësit (shkelje e nenit 6§1 i lexuar me nenin 6§3(d));
- në rastin *Berhani*¹³ - dështimi për të garantuar paraqitjen në gjykimin e kërkuësit të dëshmitarëve të caktuar, mungesa e një procedure për identifikimin e personave dhe sendeve dhe mungesa e provave bindëse në vendimet gjyqësore të brendshme që të justifikonin dënimin e kërkuësit (shkelje të nenit 6§1);
- në rastin *Laska and Lika*¹⁴ - dështimi për të korigjuar parregullsitë në fazën e hetimit të lidhura me identifikimin e të dyshuarve, gjatë gjykimin të kërkuësve (shkelje të nenit 6§1);
- në rastin *Shkalla dhe Izet Haxhia*¹⁵ - mungesa e garancive që kishin të bënin me procedurat penale të zhvilluara në mungesë të kërkuësve (shkelje të nenit 6§1);
- në rastin *Canj*¹⁶ - refuzimi për t'i dhënë kërkuësit të drejtën të mbronte veten e tij në një seancë publike para Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës së Lartë (shkelje të nenit 6§1);
- Në rastin *Kaçiu dhe Kotorri* - përdorimi i pohimeve inkriminuese të marra nga kërkuësi nëpërmjet ushtrimit të torturës në procesin kundër tij (shih më poshtë) dhe mungesa e aksesit tek një avokat gjatë arrestit policor (shkelje e nenit 6§1, 6§3(c) dhe 6§3).
- Në rastin *Shkalla dhe Izet Haxhia* - mungesa e aksesit në Gjykatën Kushtetuese, e cila llogariti afatin kohor për të apeluar pa marrë parasysh datën në të cilën kërkuësi ishin informuar në të vërtetë për vendimin kundër tyre (shkelje të nenit 6§1);

Në ato raste, Gjykata Evropiane ka përsëritur se "kur kërkuësi është dënuar, pavarësisht një shkelje të mundshme të të drejtave të tij të garantuara në nenin 6 të Konventës, ai duhet, për aq sa do të jetë e mundur, të kthehet në pozitën në të cilën do të kishte qenë nëse kërkesat e kësaj dispozite do të ishin respektuar dhe se në parim forma më e përshtatshme e kompensimit do të jetë gjykim *de novo* ose rihapja e procesit, nëse kërkohet. Rihapja e një procesi penal është e mundur në sistemin ligjor shqiptar pas ndryshimit të jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese dhe asaj të Lartë.

Në rastin *Xheraj*¹⁷ Gjykata Evropiane konstatoi shkelje të së drejtës së kërkuësit për gjykim të drejtë dhe cenimin e parimit të sigurisë juridike për shkak të shfuqizimit të një vendimi përfundimtar, që e shpallte atë të pafajshëm në lidhje me akuzat për vrasje. Më 27 nëntor 1996, kërkuësi u dënuar në mungesë për vrasje e më pas, më 14 dhjetor 1998, në përfundim

12 *Balliu k. Shqipërisë*, vendim i 16 qershorit 2005; *Caka k. Shqipërisë*, vendim i 8 dhjetorit 2009

13 *Berhani k. Shqipërisë*, vendim i 27 majit 2010

14 *Laska dhe Lika k. Shqipërisë*, vendim i 20 prillit 2010

15 *Izet Haxhia k. Shqipërisë*, vendim i 5 nëntorit 2013; *Haxhia k. Shqipërisë*, vendim i 8 tetorit 2013; *Mulosmani k. Shqipërisë*, vendim i 8 tetorit 2013; *Shkalla k. Shqipërisë*, vendim i 10 majit 2011

16 *Canj k. Shqipërisë*, vendim i 6 marsit 2011

17 *Xheraj k. Shqipërisë*, vendim i 29 korrikut 2008

të procesit të rishikimit gjyqësor u shpall i pafajshëm. Vendimi i pafajësisë mori formë të prerë më 24/12/1998. Më 02/10/1999, jashtë afateve të përcaktuara ligjore, prokurori nisi procedurat ankimore kundër vendimit të pafajësisë, duke argumentuar në mënyrë të veçantë se familja e viktimës nuk ishte njoftuar lidhur me të. Apeli i prokurorit u pranua dhe lirimi i kërkuesit u hodh poshtë nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë më 20/06/2001. Kërkuesi u njoftua për rrëzimin e vendimit të pafajësisë në 2002 kur autoritetet shqiptare kërkuan, në bazë të vendimit të Gjykatës së Lartë të datës 20/06/2001, ekstradimin i tij nga Italia ku ai vuante dënimin për vepra të tjera.

Gjykata Evropiane vërejti se familja e viktimës nuk ishte përfshirë në gjykim edhe pse kishte pasur alternativa në dispozicion, që bënin të mundur përfshirjen e tyre. Më tej, ajo vuri në dukje se prokurori kishte pasur mundësi të apelonte vendimin e lirimit të kërkuesit brenda afatit ligjor dhe arriti në përfundimin se apelimi i prokurorit dhe rrëzimi i vendimit të pafajësisë së kërkuesit kishte sjellë një ekuilibër jo të drejtë ndërmjet interesave të kërkuesit dhe efektivitetit të sistemit të drejtësisë penale dhe kishte cenuar parimin e sigurisë juridike. Gjykata Evropiane i akordoi kërkuesit dëmshpërblim në lidhje me dëmet jo materiale. Duke vënë në dukje se megjithatë kërkuesi kishte vazhduar të ishte subjekt i pasojave të rrëzimit të vendimit të pafajësisë, Gjykata vlerësoi se forma më e përshtatshme e kompensimit për këtë situatë që kishte vazhduar do të ishte konfirmimi përfundimtar i pafajësisë së kërkuesit dhe dënimi i tij, i dhënë në shkelje të Konventës të fshihej.

Neni 6§1: aksesit në gjykatë

Në rastin *Dauti*¹⁸, Gjykata Evropiane konstatoi shkelje të së drejtës së kërkuesit për të pasur akses në gjykatë në vitin 2004, në procedurat që kundërshtonin vendimet administrative të komisionit të ankesave, që kishin të bënin me përfitimet për statusin e invalidit. Në veçanti, Gjykata Evropiane vërejti se, komisioni i ankesave ishte i përbërë tërësisht nga mjekë në detyrë, të emëruar nga Ministria e Shëndetësisë, nën autoritetin dhe mbikëqyrjen e së cilës mjekët punonin. Në këtë komision nuk kishte asnjë anëtar të kualifikuar ligjor apo gjyqësor, dhe ligji e rregulloret e brendshme nuk përmbanin rregulla, të cilat rregullonin mandatin e anëtarëve në detyrë, largimin e tyre, dorëheqjen apo ndonjë garanci për zëvendësimin e tyre. Rregullat ligjore nuk ofronin mundësinë e betimit të anëtarëve të tij. Duke se ata mund të shkarkoheshin nga funksioni në çdo kohë, sipas dëshirës së Ministrisë së Shëndetësisë, e cila ushtronte diskrecion të pakufizuar. Kështu, pozicioni i anëtarëve të komisionit të ankesave ishte i hapur ndaj presioneve të jashtme dhe një situatë e tillë mund të cenonte pavarësinë e tij. Prandaj, Gjykata vërejti se komisioni i ankesave nuk mund të konsiderohej si një "gjykatë e pavarur dhe e paanshme", siç kërkohet nga neni 6§1 i Konventës dhe vendimet e tij, sipas ligjit në fuqi në atë kohë, nuk mund të kundërshtoheshin para një gjykate vendase.

Neni 6, neni 1 i Protokollit nr. 1 dhe neni 13 i Konventës: problemi sistematik i moszbatimit të vendimeve përfundimtare të brendshme dhe mungesa e mjeteve ligjore efektive

Nga vendimet e dhëna lidhur me Shqipërinë, 27 prej tyre kanë të bëjnë me shkelje të nenit 6§1, nenit 1 të Protokollit nr. 1 dhe nenit 13 të Konventës.

Këto raste të quajtura *grupi i rasteve Driza* ngrinin problemin strukturor të moszbatimit të vendimeve të brendshme përfundimtare gjyqësore dhe administrative, në lidhje me të drejtën e kërkuesve për kthimin ose kompensimin (në para ose në natyrë) të pronës së shtetëzuar gjatë regjimit komunist dhe mungesës së një mjeti efektiv ligjor në këtë drejtim. Duke parë shkallën e gjerë të problematikës, Gjykata Evropiane mori një vendim pilot, *Manushaqe Puto dhe të Tjerët*¹⁹. Ky vendim kishte të bënte me një seri vendimesh në periudhën ndërmjet 1994 -1999, të dhëna nga komisionet që shqyrtonin kërkesat pronësore, që kishin njohur të drejtën e pronësisë së kërkuesve mbi disa parcela toke dhe kishin vendosur kompensimin e tyre. Gjykata konstatoi se kuadri i brendshëm ligjor nuk ofronte zgjidhje efektive për të bërë të mundur dëmshpërblimin e përshtatshëm dhe të mjaftueshëm në lidhje me moszbatimin e vendimeve të komisionit, që njihnin të drejtën e kërkuesve për kompensim. Duke parë problematikën e mekanizmit të kompensimit në Shqipëri, e cila vazhdoi

18 *Dauti k. Shqipërisë*, vendim i 3 shkurtit 2009; *Driza k. Shqipërisë*, vendim i 13 nëntorit 2007

19 *Manushaqe Puto dhe të Tjerët k. Shqipërisë*, vendim i 31 korrikut 2012

të sillej para Gjykatës edhe pas vendimit edhe në një seri rastesh të tjera (*Driza dhe Ramadhi*) dhe të nevojës urgjente për zgjidhje të shpejtë dhe të duhur në nivelin e brendshëm kundrejt kërkuesve, Gjykata e konsideroi të domosdoshme aplikimin e procedurës vendim-pilot. Sipas nenit 46, Shqipëria duhej të ndërmerre masa të përgjithshme, si një çështje urgjente, në mënyrë që të sigurohej në mënyrë efektive e drejta e kompensimit.

Në lidhje me këtë, Gjykata Evropiane kërkoi ngritjen e një mekanizmi efektiv kompensimi brenda 18 muajve, konkretisht brenda 17 qershorit 2014. Ajo theksoi nevojën për të krijuar një bazë të dhënash dhe një faturë të përgjithshme kompensimi, që do të shoqërohej me një skemë të qartë dhe të detajuar kompensimi. Për të lehtësuar presionin mbi buxhetin do të ishin të preferueshme forma alternative të kompensimit. Për sa i përket procedurës, që duhej ndjekur në raste të ngjashme, Gjykata vendosi se procedurat lidhur me kërkesat e reja të paraqitura pas vendimit të Gjykatës Evropiane do të shtyheshin për tetëmbëdhjetë muaj, por nuk do të kishte shtyrje të kërkesave të paraqitura para kësaj date.

Afati i vendosur nga Gjykata për marrjen e masave nuk u respektua nga autoritetet dhe Gjykata vendosi të rifillonte procedurat për kërkesat e ngjashme.²⁰

Në dy vendime vijuese miratuar në Komitet, përkatësisht *Metalla dhe të Tjerët*²¹ dhe *Siliqi dhe të Tjerët*²², Gjykata konstatoi të njëjtat shkelje. Më 10 nëntor 2015, Gjykata Evropiane dha një vendim në një rast të ngjashëm, *Sharra dhe të Tjerët*²³. Sipas nenit 41, Gjykata dha një shpërblim të drejtë llogaritur mbi bazën e hartave të vlerësimit të pronave të vitit 2008, aplikuar në vazhdimësi në rastet e mëparshme. Në këtë kontekst, ajo vuri në dukje se hartat e vlerësimit të vitit 2014 nuk pasqyrojnë objektivisht vlerën aktuale të tregut.

Neni 6§1: Raste të tjera të mosekzekutimit të vendimeve përfundimtare të brendshme

Në rastin *Qufaj*²⁴, Gjykata Evropiane konstatoi shkelje të së drejtës së kompanisë kërkuese për gjykim të drejtë, për shkak të moszbatimit të një vendimi përfundimtar gjyqësor (shkelje e nenit 6§1). Ky ishte vendimi i parë kundër Shqipërisë ku Gjykata konstatoi shkelje. Gjykata e Apelit Tiranë kishte urdhëruar Bashkinë e Tiranës për t'i paguar kompensim kompanisë kërkuese për humbjet që kishin ardhur si pasojë e refuzimit të dhënies së një leje ndërtimi. Megjithatë, vendimi nuk u zbatua dhe kompania iu drejtua Gjykatës Kushtetuese, e cila deklaroi se proceset e zbatimit të vendimeve nuk ishin në juridiksionit e saj. Gjykata Evropiane kujtoi se ekzekutimi i vendimeve gjyqësore është pjesë integrale e "gjykimit" për qëllime të nenit 6 dhe se vonesa në ekzekutimin e vendimit mund të dëmtojë thelbin e së drejtës për një gjykim të drejtë.

Në rastin *Gjyli*²⁵, Gjykata Evropiane konstatoi shkelje të të drejtës së kërkuesit për akses në gjykatë, për shkak të dështimit nga ana e Ministrisë së Punës për të zbatuar një vendim përfundimtar të brendshëm, që urdhëronte rikthimin e tij në postin e drejtorit të një Qendre të Formimit Profesional. Gjithashtu u konstatua dhe mungesa e mjeteve efektive ligjore në këtë drejtim. Gjykata Evropiane vërejti se jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese nuk ofronte asnjë mjet efektiv, pasi edhe pse Gjykata Kushtetuese mund të konstatonte mos zbatim të vendimeve, në shkeljen të drejtës së kërkuesit për akses në gjykatë, ajo nuk kompensonte dëmin e pësuar, duke parandaluar në këtë mënyrë shkeljen e pretenduar ose vijimësinë e saj. Gjithashtu, Gjykata vuri në dukje se veprimet e përmbartimit nuk kishin qenë efektive në këtë rast. Gjykata gjeti një shkelje të ngjashme në rastin e fundit *Valio Shipping Company*²⁶.

20 *Manushaque Puto dhe të Tjerët k. Shqipërisë*, vendim i 31 korrikut 2012

21 *Metalla dhe të Tjerët k. Shqipërisë*, vendim i 16 korrikut 2015 (përfundimtar)

22 *Siliqi dhe të Tjerët k. Shqipërisë*, vendim i 10 marsit 2015 (përfundimtar)

23 *Sharradhe të Tjerët k. Shqipërisë*, vendim i 10 nëntorit 2015 (përfundimtar)

24 *Qufaj k. Shqipërisë*, vendim i 18 nëntorit 2004

25 *Gjyli k. Shqipërisë*, vendim i 7 dhjetorit 2010

26 *Valio Shipping Company k. Shqipërisë*, vendim i Komitetit të 6 tetorit 2015

Neni 6§1: zgjatja e paarsyeshme e procedurave civile dhe mungesa e mjeteve ligjore efektive

Rasti më i fundit, *Topollaj*²⁷, kishte të bënte me kohëzgjatjen e dy serive procedurash para gjykatave shqiptare, duke përfshirë të drejtat pronësore të disa pronarëve për një sipërfaqe toke dhe vlefshmërinë e një numri kontratash biznesi, që Z. Topallaj kishte lidhur me pronarët e tokave. Gjykata Evropiane konstatoi shkelje të nenit 6§1 për arsye se këto procedura kishin zgjatur për 9 vjet, 4 muaj dhe 8 ditë para të gjitha niveleve të juridiksionit. Natyra e problemit të rastit në fjalë ishte disi komplekse. Gjykatat e brendshme kanë ndikuar në këtë kohëzgjatje duke ja kthyer çështjen mbrapsht gjykatave më të ulëta për rishqyrtim. Nuk kishte asnjë shpjegim për një dështim të tillë, dështim ky që nuk varej nga kërkuesi.

Një rast tjetër i rëndësishëm është *Bici*²⁸, i cili ka të bëjë me kohëzgjatjen e procedurave para Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të Durrësit lidhur me njohjen, kthimin dhe/ose kompensimin e pronës. Gjykata Evropiane gjeti shkelje të nenit 6§1 për arsye se këto procedura kishin zgjatur për 11 vjet, 9 muaj dhe 18 ditë para një niveli të vetëm juridiksioni. Çështja në fjalë nuk ishte komplekse. Nuk kishte asnjë shpjegim për një dështim të tillë dhe se ky dështim nuk varej nga kërkuesi.

Rasti *Luli*²⁹ kishte të bënte me zgjatjen e tepruar të procedurave civile para organeve të ndryshme prej vitit 1996 e deri më tani. Gjykata Evropiane kritikoi në veçanti, dështimin e sistemit gjyqësor për të menaxhuar siç duhej një shtim të proceseve, që lidheshin me të njëjtën problematikë. Në rastin e Lulit, i cili mund të konsiderohet si një vendim pothuajse pilot, Gjykata rekomandoi sipas nenit 46, marrjen e masave për të zgjidhur problematikën e shtyrjeve sistematike të proceseve³⁰. Gjykata Evropiane vërejti se kohëzgjatja e tepruar e procedurave po shndërrohej në një mangësi serioze e proceseve ligjore të brendshme në Shqipëri dhe se kërkohet marrja e masave të përgjithshme në nivel kombëtar në lidhje me ekzekutimin e vendimeve, në veçanti, duke gjetur një zgjidhje të brendshme sa i përket kohëzgjatjes së panevojshme të procedimeve. Gjykata ka konstatuar shkelje të ngjashme edhe në tre raste të tjera, *Marini*, *Mullai* dhe *Mishgjoni*.

Rasti *Marini*³¹ kishte të bënte me kohëzgjatjen e tepruar të dy proceseve civile, njëri zgjati nga 1993 deri në 2003 dhe tjetri nga 1997 deri në 2006 (shkelje e nenit 6§1). Në njëri prej këtyre proceseve, Gjykata Evropiane vërejti se çështja i ishte referuar në mënyrë të përsëritur juridiksioneve më të ulëta për rishqyrtim. Ajo më pas vërejti se duke dhënë një sërë vendimesh kontradiktore në shkallë të ndryshme të gjykimit, autoritetet shqiptare kishin shfaqur mangësi të sistemit gjyqësor për të cilin ishin përgjegjës. Gjithashtu, Gjykata vendosi se nuk kishte zgjidhje ligjore në dispozicion të kërkuesit në lidhje me vonesat në procedurë (shkelje e nenit 13).

Ky rast kishte të bënte gjithashtu edhe me shkeljen e të drejtës së kërkuesit për akses në gjykatë, duke qenë se Gjykata Kushtetuese nuk ishte shprehur në lidhje me ankesën e kërkuesit dhe efektivisht refuzoi të merrte një vendim (shkelje të nenit 6§1). Gjykata Evropiane vërejti se Gjykata Kushtetuese kishte deklaruar se ajo nuk mund të vendoste në lidhje me ankesën e kërkuesit për shkak mosarritjes së shumicës së kërkuar të votave, edhe pse kolegji përbëhej nga shtatë gjyqtarë, asnjë prej të cilëve nuk mund të abstenonte. Duke qenë se Gjykata Kushtetuese nuk arriti të jepte ndonjë arsye për këtë rezultat, Gjykata Evropiane arriti në përfundimin se Gjykata Kushtetuese nuk mundi të arrinte një shumicë votash në asnjë nga çështjet në gjykim.

Më tej, rasti kishte të bënte me mosekzekutimin e vendimit përfundimtar të Komisionit të Arbitrazhit Shtetëror, i cili urdhëronte Shtetin të respektonte angazhimet e tij të partneritetit në një kompani të përbashkët të ngritur me kërkuesin. Ky vendim kishte mbetur i paekzekutuar për 10 vjet, derisa ndërmarrja e përbashkët u likuidua në 2003 (shkelje e nenit 6§1). Së fundi, në rastin në fjalë ishte shkelur e drejta e kërkuesve për gëzimin paqësor të pasurisë së tyre (shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1) pasi shteti kishte refuzuar të respektonte detyrimet e kompanisë, dështimi i tij për të zbatuar vendimet e

27 *Topollaj k. Shqipërisë*, vendim i 21 prillit 2016.

28 *Bici k. Shqipërisë*, vendim i 3 dhjetorit 2015.

29 *Luli dhe të Tjerët Others k. Shqipërisë*, vendim i 1 prillit 2014

30 *Si në Scordino k. Italisë* (nr. 1) Dhomë e Madhe, vendimi i 29 marsit 2006, paragrafët 182 deri në 189

31 *Marini k. Shqipërisë*, vendim i 7 korrik 2008

marra nga gjykatat në favor të kërkuessit dhe kohëzgjatja e procedurave e bënë kërkuessin një aksioner pasiv duke e bërë të pamundur marrjen e fitimeve të pritshme. Mënyra si u zhvilluan proceset dhe pasiguria që iu krijua kërkuessit, prishën “ekuilibrin e drejtë” që duhej ruajtur mes interesit publik dhe të drejtave të kërkuessit.

Në rastin *Mishgjon*³², Gjykata Evropiane konstatoi se procedura e shkarkimit të gjyqtares përpara Këshillit të Lartë të Drejtësisë kishte qenë tepër e gjatë dhe nuk kishte asnjë mjet ligjor efektiv në dispozicion të kërkuesses.

Në rastin *Mulla*³³, Gjykata konstatoi shkelje të parimit të sigurisë juridike pasi kërkuessit, të cilët ishin pronarë të një sipërfaqeje toke në Tiranë dhe një kompani zhvillimi të pronës, me të cilën ata kishin lidhur një marrëdhënie kontraktuale, nuk mund të merrnin një vendim përfundimtar gjyqësor në lidhje me vlefshmërinë e një leje ndërtimi që ishte dhënë, e më pas ishte anuluar e më pas ridhënë përsëri në një seri procesesh (shkelje të nenit 6§1).

Gjithashtu kërkuessit në këtë rast u ankuan për shkelje të së drejtës së tyre për gëzimin paqësor të pronës së tyre pasi kishin prishur një vilë, e cila ndodhej në sipërfaqen e tokës në mënyrë, që të zhvillonin vendin në bazë të lejes së ndërtimit, e cila ishte shfuqizuar më pas (shkelje të nenit 1 të Protokollit nr.1).

Gjykata Evropiane konstatoi se mënyra se si autoritetet vendase kishin proceduar nuk ishte aspak në përputhje me detyrimin e shtetit për të trajtuar situatën e kërkuessve në mënyrën më të qartë dhe koherente të mundshme dhe qartazi kishte një mungesë të vazhdueshme të qartësisë dhe sigurisë. Në lidhje me të drejtat e pronësisë të kërkuessve, Gjykata arriti në përfundimin se ndërhyrja në të drejtat e shoqërisë kërkuessve dhe kërkuessve individualë, që kishin prishur këtë vilë për shkak të lejes së ndërtimit të lëshuar nga autoritetet, nuk mund të konsiderohet i ligjshëm brenda kuptimit të nenit 1 të Protokollit nr.1.

Neni 7

Në lidhje me nenin 7 është dhënë një vendim, rasti *Alimuçaj*, në të cilin u konstatua shkelje dhe jo-shkelje.³⁴ Gjykata Evropiane konstatoi shkelje të parimit të ligjshmërisë së veprave penale dhe dënimeve, pasi kërkuessit i ishte dhënë një dënim më i rëndë sesa ai që parashikohej në kohën e kryerjes së veprës penale, për të cilën ishte shpallur fajtor dhe ishte dënuar me 20 vjet burgim në 2002 (shkelje të nenit 7). Nuk ka pasur shkelje në lidhje me faktin nëse veprimet e kërkuessit përbënin një vepër penale sipas të drejtës së brendshme. Kërkuessi u lirua më 3 maj 2010.

Neni 8

Ka pasur dy raste lidhur me të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare sipas nenit 8.³⁵ Vetëm në një nga rastet u konstatua shkelje, konkretisht në rastin *Bajrami*³⁶. Ky rast kishte të bënte me shkeljen e të drejtës së kërkuessit për respektimin e jetës familjare për shkak të dështimit të autoriteteve shqiptare për të ndërmarrë masat e nevojshme për ribashkimin me vajzën e tij (shkelje e nenit 8). Në janar 2004 vajza e kërkuessit ishte marrë nga nëna e saj në Greqi pa pëlqimin e tij. Më 4 shkurt 2004 Gjykata e Rrethit Vlorë vendosi zgjidhjen e martesës dhe dhënien e kujdestarisë së fëmijës kërkuessit. Edhe pse kërkuessi në mënyrë të përsëritur kishte tentuar kthimin e vajzës së tij, vendimi asnjëherë nuk ishte zbatuar.

Sipas zyrës së përbarimit ishte e pamundur për ta zbatuar atë pasi fëmija nuk ishte në Shqipëri. Gjykata Evropiane vërejtí se Shqipëria nuk kishte ratifikuar instrumentet përkatëse ndërkombëtare për të siguruar ribashkimin e prindërve me fëmijët e tyre, përfshirë Konventën e Hagës së 1980 “Mbi Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijës”. Megjithatë,

32 *Mishgjon* k. Shqipërisë, vendim i 7 dhjetorit 2010

33 *Mullai dhe të Tjerët* k. Shqipërisë, vendim i 23 marsit 2010

34 *Alimuçaj* k. Shqipërisë, vendim i 7 shkurtit 2012

35 *Qama* k. Shqipërisë dhe Italisë, vendim i 8 janarit 2013; *Bajrami* k. Shqipërisë, vendim i 12 dhjetorit 2006

36 *Bajrami* k. Shqipërisë, vendim i 12 dhjetorit 2006

pavarësisht nga kjo, Gjykata konstatoi se sistemi ligjor shqiptar, në kohën e gjykimit, nuk ofronte një kornizë alternative ligjore që t'i siguronte kërkuesit mbrojtje praktike dhe efektive, detyrim pozitiv ky i shtetit sanksionuar në nenin 8. Duke qenë se kërkuesi ndërroi jetë më 10/11/2006, Gjykata Evropiane rishikoi vendimin e saj dhe u shpreh se dëmshpërblimi i duhej akorduar trashëgimtarëve të tij.

Në rastin tjetër, i cili gjithashtu kishte të bënte me detyrimin pozitiv të shtetit për të lehtësuar ribashkimin mes prindërve dhe fëmijëve nuk u konstatua asnjë shkelje.³⁷

Neni 13

22 vendime janë dhënë në lidhje me nenin 13, të gjitha në lidhje me nenin 6 dhe/ose të nenit 1 të Protokollit nr.1.

Protokolli Nr. 7, neni 4

1 vendim është dhënë në lidhje me nenin 4 të Protokollit nr. 7, e drejta për të mos u gjykuar ose dënuar dy herë. Gjykata konstatoi shkelje për shkak të përsëritjes së proceseve penale, që kanë përfunduar me një vendim të formës së prerë, i cili ka marrë fuqi si *res judicata*.³⁸

Protokolli Nr. 13, neni 1

1 vendim është dhënë në lidhje me këtë nen, për heqjen e dënimit me vdekje. Në rastin *Rrapo*, Gjykata konstatoi se garancitë diplomatike të dhëna në lidhje me individin ishin të mjaftueshme për të shmangur rrezikun në këtë rast.³⁹

Neni 34

Në rastin *Rrapo*⁴⁰, Gjykata Evropiane konstatoi shkelje të së drejtës së kërkuesit për të paraqitur kërkesë individuale për shkak të dështimit të autoriteteve për respektimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për marrjen e një mase të përkohshme, konkretisht mos ekstradimitin e tij në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku kërkuesi rrezikonte dënimin me vdekje. Gjykata shprehu keqardhje të thellë për faktin, që gjykatat e brendshme kishin vendosur në favor të ekstradimitit të kërkuesit pa marrë garancitë e duhura se ai nuk do të përballej me dënimin me vdekje. Megjithatë ajo gjithashtu vuri në dukje se menjëherë, para ekstradimitit të tij, Ministri Shqiptar i Drejtësisë kishte marrë garancitë e nevojshme dhe kështu arriti në përfundimin se ekstradimi i kërkuesit nuk sillte rrezikun e dënimit të tij me vdekje. Kërkuesi u shpall fajtor dhe u dënua me 80 muaj burgim në SHBA.

Neni 37

Ushtrimi i së drejtës për çregjistrimin e një kërkesë për shpërblim të drejtë, pasi shuma e kompensimit e propozuar nga qeveria ishte konsideruar e arsyeshme.⁴¹

Neni 80

Gjykata dha vendim në bazë të nenit 80 vetëm në një rast.⁴² Gjykata aprovoi një kërkesë për rishikim në bazë të faktit se vdekja e vëllait të kërkuesit ishte e panjohur për Gjykatën dhe përbënte një fakt me ndikim vendimtar në rezultatin e

³⁷ *Qama k. Shqipërisë dhe Italisë*, vendim i 8 janarit 2013

³⁸ *Xheraj k. Shqipërisë*, vendim i 29 korrikut 2008.

³⁹ *Rrapo k. Shqipërisë*, vendim i 25 shtatorit 2012.

⁴⁰ *Rrapo k. Shqipërisë*, vendim i 25 shtatorit 2009

⁴¹ *Eltari k. Shqipërisë*, vendim i 10 qershorit 2014

⁴² *Manushaqe Puto dhe të Tjerët k. Shqipërisë*, vendim i 31 korrikut 2012.

gjykimit, përkatësisht dhënien e shpërblimit të drejtë. Nuk mund të mendohej se një fakt i tillë ishte i njohur nga qeveria deri më 12 mars 2013 kur ajo mori dijeni. Nuk u dhanë shpjegime nga kërkuesi se pse nuk kishte informuar gjykatën për vdekjen e të vëllait, që ndodhi më pak se një muaj nga paraqitja e kërkesës.

Neni 46

Sikurse është përmendur tashmë, në lidhje me nenin 46, Gjykata ka vendosur marrjen e masave të përgjithshme për një sërë rastesh, të cilat përfshijnë të gjitha nenin 6 dhe/ose nenin 1 të Protokollit nr. 1. Në rastin *Luli*, Gjykata rekomandoi marrjen e masave për të zgjidhur problemin e vonësive të vazhdueshme në proceset gjyqësore.⁴³ Raste të tjera për të cilat është zbatuar neni 46 kishin të bënin me marrjen e masave për të siguruar rigjykimin ose rihapjen e një procesi gjyqësor⁴⁴ për ekzekutimin e vendimeve⁴⁵ dhe sigurimin e mjeteve efektive ligjore.⁴⁶

Manushaque Puto dhe të Tjerët u konsiderua vendim pilot për çështjen e kompensimeve, në raste që kishin të bënin me kthimin dhe kompensimin e pronave.⁴⁷

GJEDNJ, në vendimin e saj pilot «*Manushaque Puto dhe të Tjerët k. Shqipërisë*», urdhëroi qeverinë shqiptare për të ngritur një skemë efikase kompensimi, duke pasur parasysh konstatimet e ndryshme në vendimin e saj. Në mënyrë që të arrihej ky qëllim, Gjykata vuri në dukje se, për autoritetet ishte e nevojshme sigurimi i një liste përfundimtare të vendimeve gjyqësore dhe administrative, të cilat u njihnin, kthenin dhe/ose kompensojnë ish-pronarëve pronën, faturat financiare që derivonin nga kjo listë, një Hartë të Vlerës së Tokës të përditësuar, miratimin e Planit të Veprimit për zbatimin e këtij vendimi pilot të Gjykatës, si edhe krijimin e një mekanizmi efektiv për ekzekutimin e vendimeve të lartpërmendura.

Qeveria shqiptare ka përgatitur Planin e Parë të Veprimit siç kërkohet në vendimin e Gjykatës së qershorit të vitit 2014. Qeveria u angazhua për ndërmarrjen e masave legjislative dhe veprimeve të duhura për të zgjidhur përfundimisht problemin e njohjes, kthimit dhe/ose kompensimit të pronarëve në Shqipëri.

Në këtë linjë, Kuvendi i Shqipërisë miratoi Ligjin nr. 133/2015 «Për Trajtimin e Pronës dhe Përfundimin e Procesit të Kompensimit të Pronave», i cili ka hyrë në fuqi më 24 shkurt 2016.

Masat e planifikuara në Planin e Dytë të Veprimit nga Qeveria për zbatimin e duhur të Ligjit nr. 133/2015 janë:

- 1) Së pari, miratimi i legjislacionit sekondar përkatës për zbatimin e ligjit "Për Trajtimin e Pronës dhe Përfundimin e Procesit të Kompensimit të Pronave". Periudha e zbatimit të këtij veprimi ishte nga marsi deri në gusht të vitit 2016. Kjo masë përfshinte miratimin e gjashtë akteve nënligjore, prej të cilave janë miratuar katër.
- 2) Së dyti, alokimi i burimeve njerëzore dhe financiare, infrastrukturës teknike dhe logjistike të Agjencisë së Trajtimit të Pronave. Afati për përfundimin e këtij veprimi ishte periudha shkurt - shtator 2016. Në kuadër të kësaj mase kanë përfunduar nën-veprimet e mëposhtme: ndarja e fondit financiar, fondi i tokës, digjitalizimi i hartës, emërtimi dhe përpunimi elektronik i rasteve, zhvillimi i sistemit software, mbledhja, strukturimi dhe procesi i formatimit të hartave, si dhe digjitalizimi i gjithë arkivit të Agjencisë. Për më tepër, kjo masë përfshin ndarjen e burimeve financiare të planit të kompensimit, një veprim që është ende në pritje.
- 3) Së treti, miratimi i një Harte të Re të Vlerës së Tokës së Përditësuar. Kjo u miratua përmes një Vendimi të Këshillit të Ministrave më 3 shkurt 2016.
- 4) Së katërti, shqyrtimi i kërkesave për të cilat nuk është marrë ende një vendim përfundimtar, si dhe kërkesat e pa shqyrtuara ende, me qëllim për të përfunduar procesin e kompensimit të pronave. Kjo masë përfshin katër nën-katëgori nga

43 *Luli dhe të Tjerët k. Shqipërisë*, vendim i 1 prillit 2014

44 *Shkalla k. Shqipërisë*, vendim i 10 majit 2011; *Laska dhe Lika k. Shqipërisë*, vendim i 20 prillit 2010

45 *Delvina k. Shqipërisë*, vendim i 8 marsit 2011; *Eltari k. Shqipërisë*, vendim i 8 marsit 2011.

46 *Hamzaraq k. Shqipërisë*, vendim i 3 shkurtit 2009; *Nuri k. Shqipërisë*, vendim i 3 shkurtit 2009; *Ramadhi dhe të Tjerët k. Shqipërisë*, vendim i 13 nëntorit 2007

47 *Manushaque Puto dhe të Tjerët k. Shqipërisë*, vendim i 31 korrikut 2012

të cilat dy janë përfunduar: krijimi i Regjistrit të Kërkesave në Pritje; dhe pranimin e kërkesave të reja brenda afatit të parashikuar në ligj. Shqyrtimi i dosjeve dhe versioni i përditësuar i regjistrit janë ende në proces. Qeveria duhet të trajtojë këtë masë përpara shkurtit të vitit 2019.

- 5) Së pesti, vlerësimi financiar i 26,000 dosjeve, të cilave tashmë ju është njohur e drejta për kompensim. Kjo masë përfshin publikimin e regjistrit të vendimeve, i cili është dorëzuar, dhe përditësimi i tij si një proces i vazhdueshëm, i cili duhet të përfundojë deri në shkurt të vitit 2019.
- 6) Së fundmi, monitorimi i përpiktë i zbatimit të ligjit, me qëllim reagimin e menjëhershëm, në funksion të zgjidhjeve të shpejta dhe efikase në rastet e problemeve dhe vonesave që mund të konstatohen gjatë zbatimit të ligjit. Kjo masë ka shtatë komponentë, të cilët përbëhen nga monitorimi i zbatimit të ligjit nga vetë Agjencia, Ministria e Drejtësisë, Këshilli i Ministrave dhe Komisioni Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, si edhe Bordi i Integritimit Evropian.

Jurisprudenca e ndarë ne nene

NENI 2- E DREJTA E JETËS

1. E drejta e çdo njeriu për jetën mbrohet me ligj. Askujt nuk mund t'i merret jeta qëllimisht, me përjashtim të rastit kur zbatohet një vendim gjyqësor me vdekje, pas dënimit për një krim për të cilin ky dënim është parashikuar me ligj.
2. Marrja e jetës nuk konsiderohet të jetë shkaktuar në kundërshtim me këtë nen në rastet kur ajo vjen si pasojë e përdorimit të forcës, që është jo më shumë se absolutisht e nevojshme:
 - a. në mbrojtje të çdo personi nga dhuna e paligjshme;
 - b. për të kryer një arrestim të ligjshëm ose për të parandaluar arratisjen e një personi, të cilit i është hequr liria ligjërish;
 - c. për të kundërshtuar, në përputhje me ligjin, një trazirë ose kryengritje.

Rastet që janë çregjistruar	1. Ceka k. Shqipëria, vendim i 23 tetorit 2012 <ul style="list-style-type: none">▪ shteti ka njohur qartësisht shkeljen dhe ka akorduar dëmshpërblimin e përshtatshëm;▪ nuk justifikohet më vazhdimi i shqyrtimit të kërkesës;▪ kryerja e hetimeve adekuate;▪ elementë të mjaftueshëm të shqyrtimit publik;▪ <u>u shqyrtuan gjithashtu pretendimet në lidhje me nenin 3 [çregjistruar].</u>
Rastet ku nuk janë konstatuar shkelje	1. Rrapo k. Shqipërisë, vendim i 25 shtatorit 2012 <ul style="list-style-type: none">▪ nota diplomatike jep garanci të mjaftueshme;▪ e përshtatshme të hamendësohet kundrejt një shteti kërkues, i cili gjithsesi ka një histori të gjatë respekti për demokracinë, të drejtat e njeriut dhe fuqinë e ligjit, dhe i cili ka marrëveshje të gjata ekstradimi me Shtetet kontraktuese;▪ Gjykata do të vlerësojë cilësinë e sigurisë së dhënë dhe nëse ajo mund ta bazojë atë në praktikatat e shtetit i cili ka paraqitur kërkesën.;▪ <u>u shqyrtuan gjithashtu pretendimet në lidhje me nenin 2 [jo shkelje]; neni 1 i Protokollit nr. 13 [jo shkelje]; neni 34 [shkelje].</u>

NENI 3 – NDALIMI I TORTURËS

Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës ose dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese.

Rastet që janë çregjistruar	1. Ceka k. Shqipërisë, vendim i 23 tetorit 2012 <ul style="list-style-type: none">▪ shteti ka njohur qartësisht shkeljen dhe ka akorduar dëmshpërblimin e përshtatshëm;▪ nuk justifikohet më vazhdimi i shqyrtimit të kërkesës;▪ kryerja e hetimeve adekuate;▪ elementë të mjaftueshëm të shqyrtimit publik;▪ <u>u shqyrtuan gjithashtu pretendimet në lidhje me nenin 2 [çregjistruar].</u>
Rastet ku janë konstatuar shkelje	1. Kaçiu dhe Kotorri k. Shqipërisë, vendim i 25 qershorit 2013 <ul style="list-style-type: none">▪ pretendim i kërkuesit krijoi prezumin e faktit se ai i ishte nënshtuar keqtrajtimin në kundërshtim me nenin 3 dhe agjentët e shtetit dhe qeveria duhej të jepte një shpjegim të arsyeshëm se si mund të ishte shkaktuar rrahja e pretenduar;▪ qeveria nuk paraqiti asnjë shpjegim të arsyeshëm për rrahjen e pretenduar;▪ prokurori nuk urdhëroi ndonjë ekzaminim mjekësor apo hetime të tjera;▪ gjyqtarët nuk kërkuan hetim për problemet shumë të dukshme fizike të kërkuesit;▪ rrahja e kërkuesit ishte e një shkalle të tillë që ai duhet të mbahej nga oficerët e policisë për në sallën e gjyqit;▪ konkluzione mund të nxirren në masën që një trajtim i tillë kishte lënë gjurmë të dukshme ku është ushtruar qëllimisht tek kërkuesi nga oficerët e policisë gjatë marrjes së tij në pyetje;▪ sjellja e dënueshme e oficerëve të policisë për një periudhë të konsiderueshme të kohës, solli si pasojë bërjen e deklaratave inkriminuese nga kërkuesi për veten dhe kërkuesin e dytë në mënyrë që t'i jepte fund dhimbjes mendore dhe fizike që ai po përjetonte;▪ u konstatua se përbënte torturë;▪ <u>u shqyrtuan pretendimet në lidhje me nenin 6 [shkelje].</u>

2. Gori k. Shqipërisë, vendim i 7 korrikut 2009

- keqtrajtimi duhet të arrijë një nivel minimal të ashpërsisë;
- gjithëçka varej nga rrethanat e rastit, të tilla si kohëzgjatja e trajtimit, pasojat fizike dhe mendore, seksi, moshë dhe gjendja shëndetësore e viktimës;
- qëllimi i trajtimit është një faktor i rëndësishëm, por mungesa e tij nuk do të thotë që nuk ka shkelje;
- elementë duhen marrë parasysh kur vlerësohet përputhshmëria e shëndetit të kërkuarit me qëndrimin e tij në burgim: kushtet mjekësore të të burgosurve; përshtatshmëria e ndihmës mjekësore dhe kujdesi i ofruar në burgim; këshillimi i vuajtjes së masës së dënimit në kushtet e gjendjes shëndetësore të ankuesit;
- u pranua se ndihma mjekësore në spitalet e burgjeve jo gjithmonë është e njëjtë me atë që merr publiku i gjerë;
- kërkuari vuante nga sëmundja e rëndë e sklerozës së shumëfishtë;
- rreziku i sëmundjes, mungesa e trajtimit adekuat, koha e gjatë e burgimit intensifikon frikën e të burgosurit;
- ngjallja e një ndjenje të tillë të fortë të pasigurisë e kombinuar me vuajtjet e tij fizike çonin në shkelje;
- u shqyrtuan pretendimet në lidhje me nenin 5 [shkelje]; neni 34 [shkelje].

3. Dybeu k. Shqipërisë, vendim i 18 dhjetorit 2007

- kushtet e burgimit;
- keqtrajtimi duhet të arrijë një nivel minimal të ashpërsisë që të bjerë në fushëveprimin e nenit 3;
- kohëzgjatja e trajtimit, pasojat fizike dhe mendore, seksi, moshë dhe gjendja shëndetësore e viktimës;
- kuptimi i çnjerëzore: e paramenduar; e zbatuar për një kohë të gjatë; lëndime të dukshme trupore ose vuajtje intensive fizike dhe mendore;
- kuptimi i poshtëruese: shkakton tek viktima ndjenja frike, ankthi dhe inferioritet si pasojë e poshtërimit dhe përuljes;
- marrja parasysh e efektit kumulativ të kushteve në të cilat mbahet i ndaluar personi;
- mbajtja parasysh e shëndetit mendor të të burgosurve;
- element: kushtet mjekësore të të burgosurve; përshtatshmëria e ndihmës mjekësore dhe kujdesi i ofruar në burgim; këshillimi i vuajtjes së masës së dënimit në kushtet e gjendjes shëndetësore të kërkuarit.

1. Rrapo k. Shqipërisë, vendim i 25 shtatorit 2012

- nota diplomatike jep garanci të mjaftueshme;
- e përshtatshme të hamendësohet kundrejt një shteti kërkuar, i cili gjithsesi ka një histori të gjatë respekti për demokracinë, të drejtat e njeriut dhe fuqinë e ligjit, dhe i cili ka marrëveshje të gjata ekstradimi me Shtetet kontraktuese;
- Gjykata do të vlerësojë cilësinë e sigurisë së dhënë dhe nëse ajo mund ta besojë atë bazuar në praktikën e shtetit, i cili ka paraqitur kërkesën;
- u shqyrtuan gjithashtu pretendimet në lidhje me nenin 2 [jo shkelje]; neni 1 i Protokollit nr. 13 [jo shkelje]; neni 34 [shkelje].

NENI 4 – NDALIMI I SKLLAVËRISË DHE I PUNËS SË DETYRUAR

1. askush nuk do të mbahet në skllavëri ose në robëri.
2. askush nuk do të shtrëngohet të kryejë një punë me dhunë ose të detyruar.
3. në kuptim të këtij neni, termi “punë e kryer me dhunë ose e detyruar”, nuk përfshin:
 - a. çdo lloj pune që i kërkohet të kryejë zakonisht një personi të ndaluar në kushtet e parashikuara nga neni 5 i kësaj konvente ose gjatë lirit të tij me kusht;
 - b. çdo lloj shërbimi i karakterit ushtarak ose, në rastin e kundërshtarëve të ndërgjegjes në vendet ku kundërshtimi i ndërgjegjes është i njohur me ligj, shërbimi që kryhet në vend të shërbimit ushtarak të detyrueshëm;
 - c. çdo lloj shërbimi që kërkohet në rast krizash ose fatkeqësish, që kërcënojnë jetën ose mirëqenien e bashkësisë;
 - d. çdo lloj pune ose shërbimi që është pjesë e detyrimeve normale qytetare.

Nuk ka pasur vendime sipas këtij neni.

ENI 5 – E DREJTA PËR LIRI DHE SIGURI

1. Çdokush ka të drejtën e lirisë e të sigurisë personale. askujt nuk mund t'i hiqet liria, me përjashtim të rasteve që vijnë dhe në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj:
 - a. kur burgoset ligjërisht pas një dënimi të dhënë nga një gjykatë kompetente;
 - b. kur arrestohet ose ndalohet ligjërisht për moszbatim të një urdhri të dhënë nga gjykata në përputhje me ligjin ose për të garantuar përmbushjen e një detyrimi të parashikuar nga ligji;
 - c. kur arrestohet ose ndalohet ligjërisht për t'u çuar përpara autoritetit gjyqësor kompetent pas dyshimit të arsyeshëm se ka kryer një veprë penale ose kur çmohet në mënyrë të arsyeshme e nevojshme për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj;
 - d. kur një i mitur ndalohet ligjërisht për qëllim edukimi të mbikqyrrur ose për ndalimin e tij të ligjshëm me qëllim që të çohet përpara autoritetit kompetent ligjor;
 - e. kur ndalohet ligjërisht për të parandaluar përhapjen e sëmundjeve ngjitëse, të personave të sëmurë mendërisht, alkoolistëve, narkomanëve ose endacakëve;
 - f. kur arrestohet ose ndalohet ligjërisht me qëllim që të ndalohet hyrja e tij e paautorizuar në atë vend, ose nëse kundër tij është duke u kryer një proces gjyqësor dëbimi ose ekstradimi.
2. Çdo person i arrestuar duhet të informohet brenda një afati sa më të shkurtër dhe në një gjuhë që ai e kupton për arsyet e arrestimit të tij dhe në lidhje me çdo akuzë që i bëhet.
3. Çdo person i arrestuar ose i paraburgosur në rrethanat e parashikuara në paragrafin 1/c të këtij neni duhet të çohet menjëherë përpara një gjyqtari ose një zyrtari tjetër të autorizuar me ligj për të ushtruar funksione gjyqësore dhe ka të drejtë të gjykohet brenda një afati të arsyeshëm ose të lirohet në gjykim e sipër. Lirimi mund të kushtëzohet me dhënien e garancive për t'u paraqitur në procesin gjyqësor.
4. Çdo person, të cilit i është hequr liria me arrestim ose me burgim, ka të drejtë të bëjë ankim në gjykatë me qëllim që kjo e fundit të vendosë, brenda një afati të shkurtër, për ligjshmërinë e burgimit të tij dhe të urdhërojë lirimin, në qoftë se burgimi është i paligjshëm.
5. Çdo person që arrestohet ose burgoset në kundërshtim me dispozitat e këtij neni ka të drejtën për të kërkuar dëmshpërblim.

Rastet ku janë konstatuar shkelje

1. Delijorgji k. Shqipërisë, vendim i 28 prillit 2015

- nëse periudha e paraburgimit "në pritje të vendimit" i kishte përfunduar afati dhe nëse ndalimi vazhdonte të ishte i ligjshëm;
- ligjshmëria në bazë të legjislacionit të brendshëm nuk është gjithmonë vendimtare;
- duhet të jetë në përputhje me qëllimin e nenit 5 § 1, i cili nuk lejon që personat të privohen nga liria në mënyrë arbitrare;
- kushtet për heqjen e lirisë sipas ligjit të brendshëm duhet të përcaktohen qartë dhe ligji duhet të jetë i parashikueshëm në zbatimin dhe pasojat e tij;
- nuk kishte arsye të dhëna për vendosjen në arrest shtëpie;
- paraburgimi vazhdonte të mos ishte i ligjshëm;
- Neni 5 § 4 kërkon që kërkesa për lirim të trajtohet me shpejtësi;
- vonesat i atribuohen shtetit.

2. Gori k. Shqipërisë, vendim i 7 korrikut 2009

- ndalimi i kërkuesit nuk kishte baza në të drejtën e brendshme;
- edhe vetë gjykatat vendase nuk ishin të qarta se cili version i legjislacionit duhej zbatuar në rastin e kërkuesit;
- nëse gjykatat vendase do të zbatonin dispozitën e re, atëherë dënimi i kërkuesit mund të bëhej i vlefshëm, por kjo do të thoshte zbatim prapaveprues i dispozitës ligjore, i cili është i paligjshëm;
- është thelbësore që kushtet për heqjen e lirisë sipas së drejtës së brendshme të përcaktohen qartë dhe vetë ligji të jetë i parashikueshëm në mënyrë që të respektohet kriteri i ligjshmërisë i përcaktuar nga Konventa;
- nevoja e parashikimit në një shkallë që është e arsyeshme, me këshillimin e duhur, të pasojave që një veprim i caktuar mund të sjellë;
- u konstatua gjithashtu shkelje të nenit 3 dhe nenit 36.

ENI 6 – E DREJTA PËR NJË PROCES TË RREGULLT

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohej drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjyqit mund t'i ndalohej shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.
2. Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.
3. Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme:
 - a. të informohet brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë që ai e kupton dhe në mënyrë të hollësishme, për natyrën dhe për shkakun e akuzës që ngrihet ndaj tij;
 - b. t'i jepet koha dhe lehtësitë e përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes;
 - c. të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij, ose në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin, t'i mundësohet ndihma ligjore falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë;
 - d. të pyesë ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës;
 - e. të ndihmohet falas nga një përkthyes në qoftë se nuk kupton ose nuk flet gjuhën e përdorur në gjyq.

1. Topallaj k. Shqipërisë, vendim i 21 prillit 2016

- Kohëzgjatja e procedurave të brendshme për 9 vjet, 4 muaj, 8 ditë;
- Kthim për rigjykim disa herë i çështjes;
- u shqyrtuan gjithashtu pretendimet në lidhje me nenin 13 [shkelje]; dhe nenin 46.

2. Bici k. Shqipërisë, vendim i 3 dhjetorit 2015

- kohëzgjatja e procedurave të brendshme lidhur me njohjen, kthimin dhe / ose kompensimin e pronës (11 vjet, 9 muaj dhe 18 ditë para një niveli të vetëm juridiksioni).

3. Marku k. Shqipërisë, vendim i 15 korrikut 2014

- kufizim i të drejtës për t'u drejtuar gjykatës;
- kërkuesi ka marrë një vendim në favor të tij, por nuk ishte në gjendje të niste procedura për të marrë një përcaktim final për sa i përket kërkesës së tij në lidhje me njohjen e statusit të veteranit të luftës.

4. Luli dhe të tjerë k. Shqipërisë, vendim i 1 prillit 2014

- kohëzgjatja e procedurave të brendshme;
- u shqyrtuan gjithashtu pretendimet në lidhje me nenin 46.

5. Izet Haxhia k. Shqipërisë, vendim i 5 nëntorit 2013

- kërkuesi nuk kishte njohuri të mjaftueshme të procedurave ligjore kundër tij;
- ai nuk hoqi dorë nga e drejta e tij për të dalë në gjyq;
- kërkuesi nuk e pati mundësinë e një rishqyrtimi të themelit të akuzave kundër tij nga një gjykatë, e cila do ta kishte dëgjuar atë në një proces, i cili do të ishte në përputhje me garancitë për një gjykim të drejtë sipas nenit 6.

6. Kaçi dhe Kotorri k. Shqipërisë, vendim i 25 qershorit 2013

- aksesit tek një avokat është i nevojshëm që nga momenti i marrjes në pyetje nga policia, përveç nëse ekzistojnë arsye të forta që e përjashtojnë diçka të tillë;
- nuk i takon gjykatës të përcaktojë se çfarë është provë e pranueshme apo çfarë është një gabim i faktit apo ligjit;
- pranimi i deklaratave të marra si rezultat i torturës ose keqtrajtimit të tjera në shkelje të nenit 3 e bën të gjithë procedimin të padrejtë, pavarësisht nga vlera e këtyre deklaratave dhe pavarësisht nëse përdorimi i tyre është vendimtar për dënimin e të pandehurit;
- procesi, në tërësi u konsiderua i padrejtë për shkak të pranimit dhe përdorimit të deklaratës inkriminuese të kërkuesit të parë të marrë nëpërmjet torturës;
- kohëzgjatja e procedurave – tepër të gjata, mbi 6 vjet;
- u shqyrtuan gjithashtu pretendimet në lidhje me nenin 3 [shkelje].

7. Delvina k. Shqipërisë, vendim i 21 majit 2013

- u vendos për shpërbllim të drejtë;
- u shqyrtuan gjithashtu pretendimet në lidhje me nenin 13 dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1.

8. Manushaque Puto dhe të Tjerët k. Shqipërisë, vendim i 31 korrikut 2012

- mungesë e zbatueshmërisë për 15 deri 17 vjet;
- nuk ka arsye për të vendosur ndryshe nga jurisprudenca e mëparshme që vonesa të tilla i konsideron shkelje;
- Shteti nuk mund të përdorë mungesën e disponueshmërisë së fondeve si justifikim për shlyerjen e borxheve të vendimeve;
- u shqyrtuan gjithashtu pretendimet në lidhje me nenin 13 i lexuar në lidhje me nenin 6 [shkelje], nenin 1 të Protokollit Nr. 1 [shkelje] dhe nenin 46.

9. Cani k. Shqipërisë, vendim i 6 marsit 2012

- është e një rëndësie themelore që i pandehuri të paraqitet në gjykimin e tij si për shkak të të drejtës së tij për gjykim, edhe për shkak të nevojës për të verifikuar saktësinë e deklaratave të tij dhe për t'i krahasuar me ato të viktimës dhe të dëshmitarëve;
- paraqitja e të pandehurit personalisht nuk merr të njëjtën rëndësi thelbësore për një seancë apeli, siç ka për gjykimin, pasi në to nuk përcaktohen fakte, por thjesht interpretohen rregulla ligjore;
- megjithatë, kur një Gjykatë e Apelit bën një rivlerësim të fajësisë apo pafajësisë, ajo nuk mund t'a përcaktojë pa një vlerësim të drejtpërdrejtë të provave të dhëna personalisht;
- në asnjë fazë të procedimeve në apel kërkuesi nuk pati mundësi të argumentonte personalisht se ekzistonin faktorë lehtësues;
- duhej të ishte dëgjuar në seancë.

10. Shkalla k. Shqipërisë, vendim i 10 majit 2011

- e drejta për t'iu drejtuar gjykatës nuk është absolute;
- u nënshtrohet kufizimeve që rrjedhin veçanërisht në lidhje me kushtet e pranueshmërisë së një ankimi;
- kufizimet nuk duhet të kufizojnë apo pakësojnë aksesin e një personi në një mënyrë apo shtrirje të tillë që dëmton vetë thelbin e së drejtës;
- kufizime të tilla nuk janë në përputhje me nenin 6 § 1, nëse ato nuk ndjekin qëllimin e legjitimuar ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme e proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit të ndjekur;
- informimi i një personi mbi procedimin penal të filluar ndaj tij është një akt ligjor me një rëndësi të tillë që duhet të zbatohet në përputhje me kërkesat procedurale dhe të mirëfillta të afta për të siguruar ushtrimin efektiv të të drejtave të akuzuarit;
- dijenitë e paqarta dhe të parregullta nuk mjaftojnë;
- nuk është treguar se ankuesi kishte dijeni të mjaftueshme të procedurave ligjore ndaj tij;
- u shqyrtuan gjithashtu pretendimet në lidhje me nenin 46.

11. Caush Driza k. Shqipërisë, vendim i 15 marsit 2011

- mos ekzekutimi i vendimit;
- analogji me Beshiri dhe të Tjerët, Driza dhe Vrioni dhe të Tjerët;
- u shqyrtuan gjithashtu pretendimet në lidhje me nenin 13 i shqyrtuar në lidhje me nenin 6 [shkelje], nenin 1 të Protokollit Nr. 1 [shkelje].

12. Delvina k. Shqipërisë, vendim i 8 marsit 2011

- mos ekzekutimi i vendimit;
- kërkuesi nuk duhet nisë procedurat e zbatimit që një vendim të ekzekutohet;
- analogji me Beshiri dhe të Tjerët, Driza dhe Vrioni dhe të Tjerët;
- u shqyrtuan gjithashtu pretendimet në lidhje me nenin 13 i shqyrtuar në lidhje me nenin 6 [shkelje], nenin 1 të Protokollit Nr. 1 [shkelje] dhe nenin 46.

13. Eltari k. Shqipërisë, vendim i 8 marsit 2011

- mos ekzekutimi i vendimit;
- analogji me Beshiri dhe të Tjerët, Driza dhe Vrioni dhe të Tjerët;
- u shqyrtuan gjithashtu pretendimet në lidhje me nenin 13 i shqyrtuar në lidhje me nenin 6 [shkelje], nenin 1 të Protokollit Nr. 1 [shkelje] dhe nenin 46.

14. Mishgjoni k. Shqipërisë, vendim i 7 dhjetorit 2010

- mos ekzekutimi i vendimit;
- kohëzgjatja e procedurave në 3 nivelet e juridiksionit 8 vjet;
- vonesa nuk ishte për faj të kërkuesit;
- interesi i madh vetjak i të punësuarit në sigurimin e një vendimi gjyqësor menjëherë;
- një vonesë e përgjithshme prej thujse katër vitesh për të shqyrtuar sërisht çështjen e kërkuesit nuk e plotëson kërkesën e "kohës së arsyeshme" sipas Konventës;
- u shqyrtuan gjithashtu pretendimet në lidhje me nenin 13 i shqyrtuar në lidhje me nenin 6 [shkelje].

15. Puto dhe të Tjerët k. Shqipërisë, vendim i 20 korrikut 2010

- mos ekzekutimi i vendimit cenon vet thelbin e të drejtës së kërkuesit për t'iu drejtuar gjykatës;
- u shqyrtuan gjithashtu pretendimet në lidhje me nenin 13 i shqyrtuar në lidhje me nenin 6 [shkelje], nenin 1 të Protokollit Nr. 1 [shkelje].

16. Berhani k. Shqipërisë, vendim i 27 majit 2010

- drejtësia e procesit gjyqësor;
- u takon gjykatave kombëtare të vlerësojnë provat para tyre, të vërtetojnë faktet dhe të interpretojnë të drejtën e brendshme;
- në parim Gjykata nuk ndërhy, përveç rasteve kur vendimet e marra nga gjykatat e brendshme janë arbitrare ose haptazi të paarsyeshme;
- mund të jetë e nevojshme që gjykatat të shfrytëzojnë deklaratat e bëra gjatë fazës së hetimit penal, nëse i akuzuari kishte mundësi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për t'i kundërshtuar këto deklaratat në kohën që u morën ose në një fazë të mëvonshme të procesit gjyqësor;
- dëshmitarët nuk ishte marrë në pyetje nga kërkuesi ose përfaqësuesi i tij gjatë hetimit penal;
- autoritetet nuk iu përgjigjën ankesave që ngriti kërkuesit në lidhje me mangësitë serioze në cilësinë e provave;
- u shqyrtuan gjithashtu pretendimet në lidhje nënin 6 [nuk u konstatua shkelje në lidhje me kohëzgjatjen e procedurave].

17. Laska dhe lika k. Shqipërisë, vendim i 20 prillit 2010

- e drejta e gjyqësorit kundërshtues;
- barazia e mjeteve;
- mundësia e palëve në gjykimin për të pasur njohuri dhe të komentojnë të gjitha provat e paraqitura ose vëzhgimet e depozituara për të influencuar në vendimin e gjykatave;
- prezumimi i pafajësisë;
- avokatit t'i jepet akses që në hetimin e parë të të dyshuarit nga policia, përveç nëse është e demonstruar nën dritën e rrethanave të veçanta të çdo çështjeje që ka arsye bindëse për të kufizuar këtë të drejtë;
- kërkuesit nuk u lejuan për të ngritur shqetësime për parregullsitë;
- parada e identifikimit u mbajt në mungesë të avokatëve;
- u shqyrtuan gjithashtu pretendimet në lidhje nënin 46.

18. Mullai dhe të tjerë k. Shqipërisë, vendim i 23 marsit 2010

- mungesa e sigurisë juridike;
- u shqyrtuan gjithashtu pretendimet në lidhje nënin 1 të Protokollit Nr. 1 [shkelje].

19. Bushati dhe të tjerë k. Shqipërisë, vendim i 8 dhjetorit 2009

- mos ekzekutimi i vendimit;
- vendimi ishte në lidhje me dëbimin e individëve nga prona e kërkuesve;
- kërkuesit nuk mund të ishin përgjegjës për shpenzimet e dëbimit;
- u shqyrtuan gjithashtu pretendimet në lidhje nënin 1 të Protokollit Nr. 1 [shkelje].

20. Caka k. Shqipërisë, vendim i 8 dhjetorit 2009

- neni 6 § 3 (d) dhe neni 6 § 1;
- mos garantimi i paraqitjes së dëshmitarëve;
- mos dhënia e rëndësisë së duhur dëshmimeve të dëshmitarëve.
- U shqyrtuan gjithashtu pretendimet në lidhje me: neni 6 [jo shkelje – mungesa e përfaqësimit, mos dhënia e lejes për pyetje të dyfish të për disa dëshmitarë].

21. Vrioni dhe të tjerë k. Shqipërisë, vendim i 29 shtatorit 2009

- mos ekzekutimi i vendimit;
- kohëzgjatja e procedurave për 11 vjet;
- mos zbatim për 5 vjet;
- u shqyrtuan gjithashtu pretendimet në lidhje nënin 1 të Protokollit Nr. 1 [shkelje], nënin 13 i shqyrtuar në lidhje me nënin 1 të Protokollit Nr. 1 [shkelje] dhe nënin 46.

22. Gjyli k. Shqipërisë, vendim i 29 shtatorit 2009

- mos ekzekutimi i vendimit;
- vlerësimi i arsyeshmërisë së vonësës;
- asnjë tregues se ekzekutimi kishte ndonjë kompleksitet;
- kërkuesi nuk e ka penguar zbatimin;
- përgjegjësia e përmbaruesve në zgjatjen e vonësës;
- u shqyrtuan gjithashtu pretendimet në lidhje nënin 13 i shqyrtuar në lidhje me nënin 6 [shkelje].

23. Vrioni dhe të tjerë k. Shqipërisë, vendim i 24 marsit 2009

- cenimi e sigurisë juridike;
- u shqyrtuan gjithashtu pretendimet në lidhje nënin 1 të Protokollit Nr. 1 [shkelje].

24. Hamzaraj k. Shqipërisë, vendim i 3 shkurtit 2009

- mos ekzekutimi i vendimit;
- kohëzgjatja e procedurave për 12 vjet;
- u shqyrtuan gjithashtu pretendimet në lidhje nënin 1 të Protokollit Nr. 1 [shkelje] dhe nënin 46.

25. Nuri k. Shqipërisë, vendim i 3 shkurtit 2009

- mos ekzekutimi i vendimit;
- u shqyrtuan gjithashtu pretendimet në lidhje nenin 1 të Protokollit Nr. 1 [shkelje] dhe nenin 46.

26. Dauti k. Shqipërisë, vendim i 3 shkurtit 2009

- cenim i së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës;
- Komisioni i Ankesave përbëhej vetëm nga mjekë në detyrë dhe nuk kishte anëtarë të kualifikuar ligjorë apo gjyqësorë;
- nuk kishte rregulla që të rregullonin mandatin e anëtarëve në detyrë, largimin e tyre, dorëheqjen apo ndonjë garanci për pa lëvizshmërinë e tyre.;
- Komisioni i Ankesave nuk ishte një gjykatë e pavarur dhe e paanshme.

27. Xheraj k. Shqipërisë, vendim i 29 korrik 2008

- cenimi e sigurisë juridike;
- u shqyrtuan gjithashtu pretendimet në lidhje nenin 4 të Protokollit Nr. 7 [jo shkelje].

28. Marini k. Shqipërisë, vendim i 7 korrikut 2008

- e drejta për t'iu drejtuar gjykatës;
- kufizimet të së drejtës t'iu drejtuar gjykatës;
- hapësira e vlerësimit;
- kohëzgjatja e procedurave 7 vjet, 9 vjet, 5 vjet dhe 2 vjet. Kohëzgjatja e grupit të parë dhe të dytë të procedurave u konsideruan si të paarsyeshme;
- arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurës duhet të vlerësohet në dritën e rrethanave të çështjes dhe duke iu referuar: kompleksitetit të çështjes; veprimeve të kërkuesit dhe autoriteteve; dhe çfarë rrezikonte kërkuesi;
- u shqyrtuan gjithashtu pretendimet në lidhje nenin 13 i shqyrtuar në lidhje me nenin 6 [shkelje] dhe nenin 1 të Protokollit Nr. 1 [shkelje].

29. Driza k. Shqipërisë, vendim i 13 nëntorit 2007

- procedurat e drejta;
- paanshmëria;
- paanshmëri do të thotë mungesë paragyjkimi, apo anësie;
- paanshmëria e gjyqtarëve duhet të prezumohet derisa të provohet e kundërta;
- vendimtare është nëse objektiviteti i këtyre dyshimeve është mjaftueshmërisht i bazuar;
- 3 gjyqtarë të cilët kishin vendosur tashmë në lidhje me rastin ish-in në mesin e 15 gjyqtarëve që do të vendosnin nëse vendimi i parë ishte i drejtë;
- 3 gjyqtarë duhet të vendosnin mbi një çështje për të cilën ish-in shprehur tashmë;
- mos zbatim;
- u shqyrtuan gjithashtu pretendimet në lidhje me nenin 1 të Protokollit Nr. 1 [shkelje], nenin 13 i shqyrtuar në lidhje me nenin 1 të Protokollit Nr. 1 [shkelje].

30. Ramadhi dhe të Tjerët k. Shqipërisë, vendim i 13 nëntorit 2007

- kohëzgjatja e procedurave 12 vjet;
- mos ekzekutim i vendimit;
- u shqyrtuan gjithashtu pretendimet në lidhje nenin 1 të Protokollit Nr. 1 [shkelje], nenin 13 i shqyrtuar në lidhje me nenin 6 [shkelje] dhe nenin 46.

31. Gjonboçari dhe të Tjerët k. Shqipërisë, vendim i 23 tetorit 2007

- e drejta për t'iu drejtuar gjykatës;
- mos ekzekutim i vendimit;
- kohëzgjatja e tepruar e procedurave;
- u shqyrtuan gjithashtu pretendimet në lidhje nenin 13 i shqyrtuar në lidhje me nenin 6 [shkelje].

32. Beshiri dhe të Tjerët k. Shqipërisë, vendim i 22 gushtit 2006

- mos ekzekutim i vendimit;
- 5 vjet vonesë;
- nuk ish-in marrë nga shteti ose nga përmbaruesit për respektimin e vendimit;
- u shqyrtuan gjithashtu pretendimet në lidhje nenin 1 të Protokollit Nr. 1 [shkelje].

33. Qufaj Co. sh.p.k. Shqipërisë, vendim i 18 nëntorit 2004

- drejta për t'iu drejtuar gjykatës nuk do të ishte reale nëse sistemi ligjor i një shteti do të lejonte që një vendim gjyqësor i detyrueshëm dhe përfundimtar të mos zbatohet në dëm të njëres palë;
- autoriteti shtetëror nuk mund të përdorë mungesën e fondeve si justifikim për të mos respektuar një detyrimin financiar të përcaktuar në vendim.

1. Haxhia k. Shqipërisë, vendim i 8 tetorit 2013

- neni 6 nuk përcakton rregulla mbi pranueshmërinë e provave;
- pyetja është nëse procedimet në tërësi, duke përfshirë edhe mënyrën në të cilën janë marrë prova ishte i drejtë;
- koha për përgatitjen e mbrojtjes së kërkuesit ishte e mjaftueshme;
- të pandehurit duhet të jetë në gjendje për të kundërshtuar provat kundër tyre;
- ndonjë padrejtësi në mbajtjen e një deklarate të dëshmitarit mund të rregullohet, duke siguruar dëshminë e dëshmitarit.

2. Mulosmani k. Shqipërisë, vendim i 8 tetorit 2013

- neni 6 nuk përcakton rregulla mbi pranueshmërinë e provave;
- pyetja është nëse procedimet në tërësi, duke përfshirë edhe mënyrën në të cilën janë marrë prova ishte i drejtë;
- koha për përgatitjen e mbrojtjes së kërkuesit ishte e mjaftueshme;
- kërkuesi mund të parashikojë ri klasifikimin e akuzave penale kundër tij;
- ndonjë padrejtësi në mbajtjen e një deklarate të dëshmitarit mund të rregullohet, duke siguruar dëshminë e dëshmitarit;
- mungesa e paraqitjes së një dëshmitari, i cili nuk ishte dëshmitar okular nuk ishte dëmtuese.

3. Berhani k. Shqipërisë, vendim i 27 majit 2010

- kohëzgjatja e procedurave;
- vonesa zgjati 2 vjet, 7 muaj;
- asgjë nuk tregonte se ishte faji i autoriteteve shtetërore;
- autoritetet shtetërore kanë vepruar me kujdesin e duhur;
- u shqyrtuan gjithashtu pretendimet në lidhje nenin 6 [shkelje për sa i përket procesit të rregull].

4. Caka k. Shqipërisë, vendim i 8 dhjetorit 2009

- mos përfaqësimi nga një avokat;
- refuzimi për të lejuar marrjen në pyetje të një dëshmitari të caktuar nuk konsiderohet shkelje nëse provat mund të mbështeteshin me prova të tjera materiale duke përfshirë edhe dëshmitarë të cilët ishin marrë në pyetje.
- u shqyrtuan gjithashtu pretendimet në lidhje: nenin 6 [shkelje – dështim i autoriteteve për të siguruar dëshmitarët dhe për të dhënë peshën e duhur rrëfimeve të tyre].

5. Marini k. Shqipërisë, vendim i 7 korrikut 2008

- Vonesa nuk ishin të paarsyeshme në grupet 3, 4 dhe 5 të procedurave, pasi përfshiheshin shkallë të ndryshme të juridiksionit;
- u shqyrtuan gjithashtu pretendimet në lidhje nenin 13 i shqyrtuar në lidhje me nenin 6 [shkelje], nenin 1 të Protokollit Nr. 1 [shkelje].

6. Balliu k. Shqipërisë, vendim i 27 majit 2005

- një personi të akuzuar për një vepër penale, i cili nuk dëshiron të mbrohet vetë, duhet t'i jepet mundësia për të pasur ndihmë ligjore nëpërmjet një mbrojtësi të zgjedhur prej tij;
- nëse ai nuk ka burime të mjaftueshme për të përballuar këtë ndihmë, i njihet e drejta që ta ketë këtë ndihmë falas kur e kërkojnë interesat e drejtësisë;
- duhet të përcaktojë nëse shteti mban përgjegjësi për neglizhimin e avokatit të zgjedhur nga kërkuesi, për të përmbushur detyrën e tij;
- ishte e pamundur, duke marrë parasysh pavarësinë e Dhomës së Avokatisë, për ta detyruar mbrojtësin e kërkuesit për të vepruar;
- kërkuesi nuk pranoi të mbrohej nga një avokat i caktuar kryesisht;
- kërkuesi nuk e informoi asnjëherë Gjykatën e Rrethit të Durrësit për mungesën e përfaqësuesit të tij dhe as të avokatit të caktuar kryesisht dhe as nuk kërkoi ndonjë avokat tjetër;
- autoritetet e përmbushën në nivel të mjaftueshëm detyrimin e tyre për të siguruar ndihmë ligjore, si duke shtyrë seanca, për t'i dhënë avokatit të kërkuesit mundësi për të përmbushur detyrën e tij, ashtu dhe duke caktuar një avokat sipas skemës së ndihmës ligjore.

NENI 7 – NUK KA DËNIM PA LIGJ

1. Askush nuk mund të dënohet për një veprim ose një mosveprim që, në momentin kur është kryer, nuk përbënte vepër penale sipas të drejtës së brendshme ose ndërkombëtare. Po ashtu, nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se ai që ishte i zbatueshëm në momentin kur është kryer vepra penale.
2. Ky nen nuk do të ndikojë mbi gjykimin dhe dënimin e një personi për një veprim ose mosveprim, i cili, në momentin kur është kryer, quhej vepër penale sipas parimeve të përgjithshme të së drejtës, të njohura nga kombet e qytetëruara.

Raste ku janë konstatuar shkelje	<p>1. Alimuçaj k. Shqipërisë, vendim i 7 shkurtit 2012</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ gjykata duhet të konstatojë nëse dënimi i vendosur ndaj kërkuesit ishte i parashikueshëm; ▪ shkelje pasi u vendos një dënim më i rëndë se dënimi i zbatueshëm në kohën e kryerjes së veprës penale; ▪ u shqyrtuan pretendimet në lidhje me nenin 7 [shkelje në lidhje me faktin nëse veprimet e kërkuesit përbënin vepër penale sipas së drejtës së brendshme].
Raste ku nuk janë konstatuar shkelje	<p>1. Alimuçaj k. Shqipërisë, vendim i 7 shkurtit 2012</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ kualifikimi i veprimeve të kërkuesit si mashtrim në të drejtën e brendshme, nuk duket i paarsyeshëm ose arbitrar dhe prandaj mbetet brenda rregullave përgjithësisht të pranueshme të interpretimit të ligjeve penale; ▪ u shqyrtuan pretendimet në lidhje me nenin 7 [shkelje në lidhje me parashikueshmërinë e dënimit të vendosur ndaj kërkuesit].

NENI 8 – E DREJTA PËR RESPEKTIMIN E JETËS PRIVATE DHE FAMILJARE

1. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij.
2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve.

Raste ku janë konstatuar shkelje	<p>1. Bajrami k. Shqipërisë, vendim i 12 dhjetorit 2006</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ detyrim për të lehtësuar ribashkimin prind-fëmijë; ▪ jo një detyrim absolut; ▪ megjithëse masat shtrënguese ndaj fëmijëve nuk janë të dëshirueshme, përdorimi i dënimeve nuk duhet të përjashtohet në rast të sjelljes së paligjshme të fëmijës nga ana e prindit me të cilin jeton fëmija; ▪ nevoja e shpejtësisë së veprimit në ruajtjen e marrëdhënieve prind-fëmijë; ▪ vonesat nga përmbaresit në zbatimin e vendimeve të kujdestarisë.
Raste ku nuk janë konstatuar shkelje	<p>1. Qama k. Shqipërisë dhe Italisë, vendim i 8 janarit 2013</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ të pranueshme vetëm kundër Shqipërisë; ▪ detyrim pozitiv për të lehtësuar ribashkimin prind-fëmijë; ▪ gjykata italiane kishte dhënë të drejtat e kujdestarisë.

NENI 9 – LIRIA E MENDIMIT, E NDËRGJEGJES DHE E FESË

1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së mendimit, të ndërgjegjes e të fesë; kjo e drejtë nënkupton lirinë për të ndryshuar fenë ose besimin dhe lirinë, qoftë individualisht ose kolektivisht, publikisht ose privatisht nëpërmjet kultit, mësimdhënies, praktikave dhe kryerjes së riteve.
2. Liria e shfaqjes së fesë ose besimeve të dikujt nuk mund t'i nënshtrohet kufizimeve të tjera, përveç atyre të parashikuara nga ligji dhe që përbëjnë masa të nevojshme në një shoqëri demokratike në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, të shëndetit ose të moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve.

Nuk ka pasur vendime në lidhje me këtë nen.

NENI 10 – LIRIA E SHPREHJES

1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon Shtetet që të kërkojnë licencimin e ndërmarrjeve të transmetimit audio, kinematografik ose televiziv.
2. Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t'u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.

Nuk ka pasur vendime në lidhje me këtë nen.

NENI 11 – LIRIA E TUBIMIT DHE E ORGANIZIMIT

1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së tubimit paqësor dhe të organizimit me të tjerët, duke përfshirë të drejtën e themelimit me të tjerë të sindikatave dhe të pjesëmarrjes në to për mbrojtjen e interesave të tij.
2. Ushtrimi i këtyre të drejtave nuk mund t'u nënshtrohet kufizimeve të tjera përveç atyre që parashikohen me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për ruajtjen e shëndetit ose të moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve. Ky nen nuk ndalon kufizime të ligjshme të ushtrimit të këtyre të drejtave nga pjesëtarë të forcave të armatosura, të policisë ose të administratës shtetërore.

Nuk ka pasur vendime në lidhje me këtë nen.

NENI 12 – E DREJTA PËR T'U MARTUAR

Burri dhe gruaja që kanë mbushur moshën për martesë kanë të drejtë të martohen dhe të krijojnë familje sipas ligjeve kombëtare që rregullojnë ushtrimin e kësaj të drejte.

Nuk ka pasur vendime në lidhje me këtë nen.

NENI 13 – EDREJTA PËR ZGJIDHJE EFEKTIVE

Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.

Raste ku janë konstatuar shkelje

1. Topallaj k. Shqipërisë, vendim i 21 prillit 2016

- mungesë e mjetit efektiv në lidhje me kohëzgjatjen e procedurave;
- [u shqyrtuan pretendimet në lidhje me: nenin 6§1 \[shkelje\]; nenin 46.](#)

2. Delvina k. Shqipërisë, vendim i 21 majit 2013

- u vendos shpërbllim i drejtë;
- [shqyrtuan pretendimet në lidhje me nenin 6 dhe nenin 1 të Protokollit Nr. 1.](#)

3. Manushaque Puto dhe të tjerë k. Shqipërisë, vendim i 31 korrikut 2012

- i shqyrtuar në lidhje me nenin 6;
- [u shqyrtuan pretendimet në lidhje me nenin 6 \[shkelje\], nenin 1 të Protokollit Nr. 1 \[shkelje\] dhe nenin 46.](#)

4. Caush Driza k. Shqipërisë, vendim i 15 marsit 2011

- i shqyrtuar në lidhje me nenin 6;
- [u shqyrtuan pretendimet në lidhje me nenin 6 \[shkelje\] dhe nenin 1 të Protokollit Nr. 1 \[shkelje\].](#)

5. Delvina k. Shqipërisë, vendim i 8 marsit 2011

- i shqyrtuar në lidhje me nenin 6;
- [shqyrtuan pretendimet në lidhje me nenin 6 \[shkelje\], nenin 1 të Protokollit Nr. 1 \[shkelje\] dhe nenin 46.](#)

6. Eltari k. Shqipërisë, vendim i 8 marsit 2011

- i shqyrtuar në lidhje me nenin 6;
- [u shqyrtuan pretendimet në lidhje me nenin 6 \[shkelje\], nenin 1 të Protokollit Nr. 1 \[shkelje\] dhe nenin 46.](#)

7. Mishgjoni k. Shqipërisë, vendim i 7 dhjetorit 2010

- i shqyrtuar në lidhje me nenin 6;
- u shqyrtuan pretendimet në lidhje me nenin 6 [shkelje].

8. Puto dhe të Tjerët k. Shqipërisë, vendim i 20 korrikut 2010

- i shqyrtuar në lidhje me nenin 6;
- u shqyrtuan pretendimet në lidhje me nenin 6 [shkelje] dhe nenin 1 të Protokollit Nr. 1 [shkelje].

9. Vrioni dhe të Tjerët k. Shqipërisë, vendim i 29 shtatorit 2009

- i shqyrtuar në lidhje me nenin 1 të Protokollit Nr. 1
- u shqyrtuan pretendimet në lidhje me nenin 1 të Protokollit Nr. 1 [shkelje] dhe nenin 46.

10. Gjyli k. Shqipërisë, vendim i 29 shtatorit 2009

- i shqyrtuar në lidhje me nenin 6;
- u shqyrtuan pretendimet në lidhje me nenin 6 [shkelje].

11. Marini k. Shqipërisë, vendim i 7 korrikut 2008

- i shqyrtuar në lidhje me nenin 6;
- u shqyrtuan pretendimet në lidhje me nenin 6 [shkelje në njërin aspekt; jo shkelje në aspektin tjetër] dhe nenin 1 të Protokollit Nr. 1 [shkelje].

12. Driza k. Shqipërisë, vendim i 13 nëntorit 2007

- i shqyrtuar në lidhje me nenin 1 të Protokollit Nr. 1;
- u shqyrtuan pretendimet në lidhje me nenin 6 [shkelje] dhe nenin 1 të Protokollit Nr. 1 [shkelje].

13. Ramadhi dhe të Tjerët k. Shqipërisë, vendim i 13 nëntorit 2007

- i shqyrtuar në lidhje me nenin 6;
- u shqyrtuan pretendimet në lidhje me nenin 6 [shkelje], nenin 1 të Protokollit Nr. 1 [shkelje] dhe nenin 46.

14. Gjonboçari dhe të Tjerët k. Shqipërisë, vendim i 23 tetorit 2007

- i shqyrtuar në lidhje me nenin 6;
- u shqyrtuan pretendimet në lidhje me nenin 6 [shkelje].

NENI 14 – NDALIMI I DISKRIMINIMIT

Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.

Nuk ka pasur vendime në lidhje me këtë nen

PROKOLLI 1, NENI 1 - MBROJTJA E PRONËS

Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë e tij. askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk cenojnë të drejtën e Shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera.

1. Delvina k. Shqipërisë, vendim i 21 majit 2013

- u vendos shpërblim i drejtë;
- u shqyrtuan pretendimet në lidhje me nenin 6 dhe nenin 13.

2. Manushaque Puto dhe të Tjerët k. Shqipërisë, vendim i 31 korrikut 2012

- parime të përgjithshme;
- mungesa e fondeve nuk mund të justifikojë mos respektimin e detyrimit për pagimin e një borxhi të vendosur sipas vendimit të gjykatës;
- u shqyrtuan pretendimet në lidhje me nenin 6 [shkelje], nenin 13 i shqyrtuar në lidhje me nenin 6 [shkelje] dhe nenin 46.

3. Caush Driza k. Shqipërisë, vendim i 15 marsit 2011

- pretendimi mund të konsiderohet pasuri në qoftë se është mjaftueshmërisht i përcaktuar si i zbatueshëm;
- pamundësia e ekzekutimit të vendimit gjyqësor konsiderohet ndërhyrje në të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë;
- u shqyrtuan pretendimet në lidhje me nenin 6 [shkelje] dhe nenin 13 i shqyrtuar në lidhje me nenin 6 [shkelje].

4. Delvina k. Shqipërisë, vendim i 8 marsit 2011

- parimet e përgjithshme të nenit;
- pretendimi mund të konsiderohet pasuri në qoftë se është mjaftueshmërisht i përcaktuar si i zbatueshëm;
- pamundësia e ekzekutimit të vendimit gjyqësor konsiderohet ndërhyrje në të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë;
- u shqyrtuan pretendimet në lidhje me nenin 6 [shkelje], nenin 13 i shqyrtuar në lidhje me nenin 6 [shkelje], nenin 1 të Protokollit Nr. 1 [shkelje] dhe nenin 46.

5. Eltari k. Shqipërisë, vendim i 8 marsit 2011

- parimet e përgjithshme të nenit;
- pretendimi mund të konsiderohet pasuri në qoftë se është mjaftueshmërisht i përcaktuar si i zbatueshëm;
- pamundësia e ekzekutimit të vendimit konsiderohet ndërhyrje në të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë;
- u shqyrtuan pretendimet në lidhje me nenin 6 [shkelje], nenin 13 i shqyrtuar në lidhje me nenin 6 [shkelje] dhe nenin 46.

6. Puto dhe të tjerë k. Shqipërisë, vendim i 20 korrikut 2010

- parimet e përgjithshme të nenit;
- pretendimi mund të konsiderohet pasuri në qoftë se është mjaftueshmërisht i përcaktuar si i zbatueshëm;
- pamundësia e ekzekutimit të vendimit konsiderohet ndërhyrje në të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë;
- u shqyrtuan pretendimet në lidhje me nenin 6 [shkelje] dhe nenin 13 i shqyrtuar në lidhje me nenin 6 [shkelje].

7. Mullai dhe të tjerë k. Shqipërisë, vendim i 23 marsit 2010

- 'Pasuria'ka një kuptim autonom dhe nuk kufizohet në pronësinë e mallrave fizike;
- duhet shqyrtuar rast pas rasti;
- në rastin e asetëve jo fizike Gjykata ka shqyrtuar, në veçanti, faktin nëse pozicioni ligjor në fjalë ka ngritur çështjen e interesave dhe të drejtave financiare dhe kështu ka vlerë ekonomike;
- lejet e ndërtimitin përkufizoheshin si 'pasuri';

8. Bushati dhe të tjerë k. Shqipërisë, vendim i 8 dhjetorit 2009

- mos zbatimi i vendimit i linte kërkuesit në gjendje pasigurie;
- nuk mund të gëzonin plotësisht pasurinë e tyre;
- u shqyrtuan pretendimet në lidhje me nenin 6 [shkelje].

9. Vrioni dhe të tjerë k. Shqipërisë, vendim i 29 shtatorit 2009

- pretendimi mund të konsiderohet pasuri në qoftë se është mjaftueshmërisht i përcaktuar si i zbatueshëm;
- mungesa e fondeve nuk mund të justifikojë mos respektimin e detyrimit nga ana e shtetit për pagimin e një borxhi përfundimtar dhe detyrues të vendosur sipas vendimit të gjykatës;
- u shqyrtuan pretendimet në lidhje me nenin 6 [shkelje], nenin 13 i shqyrtuar në lidhje me nenin 6 [shkelje] dhe nenin 46.

10. Vrioni dhe të tjerë k. Shqipërisë, vendim i 24 marsit 2009

- Shfuqizimi i një vendimi të zbatueshëm, dëmtonte besimin e kërkuesit se mund të mbështetej në një vendim detyrues dhe i privonte ata nga prona;
- u shqyrtuan pretendimet në lidhje me nenin 6 [shkelje].

11. Hamzaraj k. Shqipërisë, vendim i 3 shkurtit 2009

- E drejta e kompensimit si një aset;
- proporcionaliteti;
- u shqyrtuan pretendimet në lidhje me nenin 1 të Protokollit Nr. 1 [shkelje].

12. Nuri k. Shqipërisë, vendim i 3 shkurtit 2009

- e drejta për kompensim;
- u shqyrtuan pretendimet në lidhje me nenin 6 [shkelje] dhe nenin 46.

13. Marini k. Shqipërisë, vendim i 7 korrikut 2008

- aksionet kanë vlerë ekonomike dhe kështu konsiderohen pasuri;
- detyrimet pozitive të shtetit;
- mos zbatimi;
- u shqyrtuan pretendimet në lidhje me nenin 6 [shkelje] dhe nenin 13 i shqyrtuar në lidhje me nenin 6 [shkelje].

14. Ramadhi dhe të Tjerët k. Shqipërisë, vendim i 13 nëntorit 2007

- Kuptimi i pasurisë;
- hapësirë të gjerë vlerësimi për të përcaktuar se çfarë është në interes të publikut, veçanërisht në rastet e kompensimit për shtetëzimet ose shpronësimet;
- 12 dhe 11 vjet kanë kaluar dhe kërkuesi ende nuk ishte kompensuar;
- të lënë në gjendje pasigurie në realizimin e të drejtave të tyre të pronësisë;
- për një periudhë të konsiderueshme kohore, autoritetet i penguan ata nga posedimi i parave dhe tokës së tyre;
- u shqyrtuan pretendimet në lidhje me nenin 6 [shkelje], nenin 13 i shqyrtuar në lidhje me nenin 6 [shkelje] dhe nenin 46.

15. Beshiri k. Shqipërisë, vendim i 22 gushtit 2006

- neni nuk garanton të drejtën për të përfituar pronë;
- hapësira vlerësimi;
- nëse kërkuesit kanë pasur pritshmëri legjitime për kthimin e pronës së tyre;
- detyrimet e shtetit para dhe pas ratifikimit të Konventës;
- ndalimi i pagesës së kompensimit çon në konstatimin e shkeljes;
- u shqyrtuan pretendimet në lidhje me nenin 6 [shkelje].

PROTOKOLLI 7, NENI 4 – E DREJTA PËR TË MOS U GJYKUAR OSE DËNUAR DY HERË

1. Askush nuk mund të ndiqet ose të dënohet penalisht nga juridiksioni i të njëjtit Shtet për një veprë për të cilën ai më parë ka qenë me është shpallur i pafajshëm ose dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë, në përputhje me ligjin dhe procedurën penale të atij Shteti.
2. Dispozitat e paragrafit të mësipërm nuk pengojnë rihapjen e procesit, në përputhje me ligjin dhe procedurën penale të Shtetit të interesuar, në rast se fakte të reja ose të zbuluara rishtazi, ose një mangësi themelore në procedimet e mëparshme janë të një natyre të tillë që mund të cenojnë vendimin e dhënë.
3. Asnjë derogim nuk lejohet për këtë nen në përputhje me nenin 15 të Konventës.

1. Xheraj k. Shqipërisë, vendim i 29 korrikut 2008

- qëllimi i këtij neni është që të ndalojë përsëritjen e procedurës penale për të cilën është marrë një vendim i formës së prerë;
- u shqyrtuan pretendimet në lidhje me nenin 6 [shkelje].

PROTOKOLLI 13, NENI 1 – HEQJA E DËNIMIT ME VDEKJE

Dënimi me vdekje hiqet. Askush nuk mund të dënohet me një dëmin të tillë dhe as të ekzekutohet.

1. Rrapo k. Shqipërisë, vendim i 25 shtatorit 2012

- garancia diplomatike u konsiderua e mjaftueshme për të shmangur rrezikun;
- u shqyrtuan pretendimet në lidhje me nenin 2 [jo shkelje], nenin 3 [jo shkelje] dhe nenin 34 [jo shkelje].

NENI 34 – KËRKESAT INDIVIDUALE

Gjykata mund të marrë kërkesat nga çdo person, organizatë joqeveritare ose grup individësh që pretendojnë se jenë viktime të një shkelje nga një prej Palëve të Larta Kontraktuese të të drejtave të parashtruara në Konventë ose në protokollet e saj. Palët e Larta Kontraktuese zotohen të mos pengojnë në ndonjë mënyrë ushtrimin efektiv të kësaj të drejte.

Rastet kur vendimi është dhënë në lidhje me nenin 34

1. *Rrapo k. Shqipërisë, vendim i 25 shtatorit 2012*

- dështimi në përputhje me masën e përkohshme të vendosur nga Gjykata Evropiane duke treguar se kërkuesi nuk duhet të ekstradohet në SHBA, ku atij i rrezikohet dhënia e dënimit me vdekje.
- u shqyrtuan pretendimet në lidhje me: nenin 2 [jo shkelje]; nenin 3 [jo shkelje]; neni 1 i Protokollit nr 13 [jo shkelje].

NENI 37 – ÇREGJISTRIMI I KËRKESAVE

1. Në çdo fazë të procedimit, Gjykata mund të vendosë të çregjistrojë një kërkesë, kur rrethanat çojnë në përfundimin se:
 - a. kërkuesi nuk ka ndërmend ta vazhdojë çështjen; ose
 - b. çështja është zgjidhur; ose
 - c. për çdo arsye tjetër që, sipas Gjykatës, nuk justifikon vazhdimin e shqyrtimit të kërkesës. megjithatë, Gjykata vazhdon shqyrtimin e kërkesës kur këtë e kërkon respektimi i të drejtave të njeriut të garantuara nga konventa dhe protokollet e saj.
2. Gjykata mund të vendosë rifutjen e një kërkesë në listën e çështjeve kur konsideron se rrethanat ejustifikojnë këtë.

Rastet e çregjistruara

1. *Eltari k. Shqipërisë, vendim i 10 qershorit 2014*

- Kërkesa u çregjistrua pasi shuma e kompensimit e propozuar nga qeveria ishte e arsyeshme.

NENI 46 – FORCA DETYRUESE DHE EKZEKUTIMI I VENDIMEVE

1. Palët e Larta Kontraktuese marrin përsipër të respektojnë vendimin e formës së prerë të Gjykatës në çdo çështje ku ata janë palë.
2. Vendimi përfundimtar i Gjykatës i përcillet Komitetit të Ministrave, i cili mbikëqyr ekzekutimin e tij.
3. Nëse Komiteti i Ministrave është i mendimit se mbikëqyrja e ekzekutimit të një vendimi të formës së prerë pengohet nga një problem i interpretimit të vendimit, ai mund t'ja referojë çështjen Gjykatës për tu shprehur me vendim për çështjen e interpretimit. Një vendim i tillë kërkon një shumicë prej dy të tretave të përfaqësuesve që kanë të drejtë të marrin pjesë në Komitet.
4. Nëse Komiteti i Ministrave është i mendimit se një Palë e Lartë Kontraktuese refuzon të respektojë një vendim të formës së prerë në një çështje ku ajo është palë, pasi i ka dërguar një njoftim formal asaj Palë dhe me vendim që merret me shumicën e dy të tretave të përfaqësuesve që marrin pjesë në Komitet, ti referojë çështjen mund ti referojë Gjykatës problemin nëse Pala përmbushur detyrimin e saj në bazë të paragrafit 1.
5. Nëse Gjykata gjen shkelje të paragrafit 1, ajo ia referon çështjen Komitetit të Ministrave për shqyrtimin e masave që duhen marrë. Nëse Gjykata nuk gjen asnjë shkelje të paragrafit 1, ajo ia referon çështjen Komitetit të Ministrave, i cili e mbyll shqyrtimin e çështjes.

Rastet ku është zbatuar neni 46

1. *Topallaj k. Shqipërisë, vendim i 1 prillit 2014*

- Shqipëria duhet të miratojë gjetjet e paragrafit 118 të çështjes Luli dhe të Tjerët k. Shqipërisë si një çështje me prioritet;
- u shqyrtuan pretendimet në lidhje me: nenin 6§1 [shkelje]; neni 13 [shkelje];

2. *Luli dhe të tjerë k. Shqipërisë, vendim i 1 prillit 2014*

- njohja e vonesa sistematike në sistemin e brendshëm ligjor;
- masat e rekomanduara si në rastin Scordino k. Italisë (nr. 1) [DHM], nr. 36813/97 paragrafët 182-189; ▪ u shqyrtuan pretendimet në lidhje me nenin 6 [shkelje].

3. Manushaque Puto dhe të Tjerët k. Shqipërisë, vendim i 31 korrikut 2012

- vendim pilot;
- mangësitë rregullatore dhe/ose mangësi në veprimet administrative të autoriteteve në zbatimin e vendimeve përfundimtare të komisionit që akordonin kompensim për ish-pronarët sipas ligjit mbi pronën;
- Shteti i paditur duhet të marrë urgjentisht masat e përgjithshme, për të siguruar në mënyrë efektive të drejtën e kompensimit, duke vendosur një ekuilibër të drejtë ndërmjet interesave të ndryshme konkurruese;
- Shteti i paditur duhet të shmangë amendimet e shpeshta të legjislacionit dhe duhet të shqyrtojë me kujdes të gjitha implikimet ligjore dhe financiare para se të miratojë ndryshime të mëtejshme;
- skema e kompensimit nuk duhet të rëndojë mbi kërkuesin, rezultatet duhet të bëhen publike dhe të përmbajnë arsye të mjaftueshme, procesi duhet të jetë transparent;
- problemi mund të adresohet më mirë nëse i nënshtrohet diskutimeve të gjera publike, në mënyrë që publiku të kuptojë nivelin e kompensimit që Shteti pritet të paguajë realisht dhe format e ndryshme të kompensimit;
- u shqyrtuan pretendimet në lidhje me nenin 6 [shkelje], nenin 1 të Protokollit Nr. 1 [shkelje] dhe nenin 13 i shqyrtuar në lidhje me nenin 6 [shkelje].

4. Shkalla k. Shqipërisë, vendim i 10 majit 2011

- gjykata përsëriti përfundimet e saj në çështjen Laska dhe Lika, paragrafët 74 -76;
- u shqyrtuan pretendimet në lidhje me nenin 6 [shkelje].

5. Driza k. Shqipërisë, vendim i 15 marsit 2011

- kthimi i tokës brenda tre muajve nga data që vendimi ka marrë formë të prerë ose kompensim;
- heqja e pengesave për kompensim;
- u shqyrtuan pretendimet në lidhje me nenin 6 [shkelje], nenin 1 të Protokollit Nr. 1 [shkelje] dhe nenin 13 i shqyrtuar në lidhje me nenin 6 [shkelje].

6. Delvina k. Shqipërisë, vendim i 8 marsit 2011

- mungesa mekanizmave për të siguruar zbatimin e një vendimi përfundimtar të gjykatës;
- duhet të marrë masat e duhura legjislative, administrative dhe financiare për të siguruar çmime për kompensim, pa vonesa të panevojshme, të urdhëruar nga një vendim përfundimtar të gjykatës në vend të kthimit të pronës;
- duhet të marrë masat e duhura legjislative, administrative dhe financiare në mënyrë që të sigurojë kompensimin, pa vonesa të panevojshme, të urdhëruar me vendim përfundimtar të gjykatës në vend të kthimit të pronës;
- Shteti i paditur duhet, për shembull, të caktojë një organ kompetent zbatimi, të sigurojë burime të mjaftueshme njerëzore dhe materiale, të vendosë rregulla të qarta dhe të thjeshta të procedurës për mbledhjen e kërkesave, të vendosë afate kohore realiste dhe të detyrueshme për përpunimin dhe zbatimin e tyre, të akordojë fondet e nevojshme buxhetore dhe të heqë të gjitha pengesat në mënyrë që të sigurohet kompensimi financiar ose në natyrë, duke mbajtur parasysh parimet e përcaktuara në jurisprudencën e Gjykatës;
- u shqyrtuan pretendimet në lidhje me nenin 6 [shkelje], nenin 1 të Protokollit Nr. 1 [shkelje] dhe nenin 13 i shqyrtuar në lidhje me nenin 6 [shkelje].

7. Eltari k. Shqipërisë, vendim i 8 marsit 2011

- Shteti i paditur duhet të marrë masat e duhura legjislative, administrative dhe financiare në mënyrë që të sigurojë kompensimin, pa vonesa të panevojshme, të urdhëruar me vendim përfundimtar të gjykatës në vend të kthimit të pronës;
- Shteti i paditur duhet, për shembull, të caktojë një organ kompetent zbatimi, të sigurojë burime të mjaftueshme njerëzore dhe materiale, të vendosë rregulla të qarta dhe të thjeshta të procedurës për mbledhjen e kërkesave, të vendosë afate kohore realiste dhe të detyrueshme për përpunimin dhe zbatimin e tyre, të akordojë fondet e nevojshme buxhetore dhe të heqë të gjitha pengesat në mënyrë që të sigurohet kompensimi financiar ose në natyrë;
- u shqyrtuan pretendimet në lidhje me nenin 6 [shkelje], nenin 1 të Protokollit Nr. 1 [shkelje] dhe nenin 13 i shqyrtuar në lidhje me nenin 6 [shkelje].

8. Laska dhe Lika k. Shqipërisë, vendim i 20 prillit 2010

- një rigjykim ose rihapje e çështjes, nëse kërkohet nga kërkuesi, përfaqëson në parim një mënyrë të përshtatshme të korrigjimit të një shkelje;
- i takon Shtetit të paditur për të hequr nga sistemi i tij i brendshëm ligjor, pengesat që nuk lejojnë korrigjimin në mënyrë adekuate të situatës së kërkuesit apo të miratojë zgjidhje të reja ligjore që do të mundësonin korrigjimin e situatës së kërkuesve;
- ky parim vlen edhe për rihapjen e procedimeve dhe rishqyrtimin e çështjes së kërkuesve;
- u shqyrtuan pretendimet në lidhje me nenin 6 [shkelje].

9. Vrioni dhe të Tjerët k. Shqipërisë dhe Italisë, vendimi i 29 shtatorit 2009

- gjykata përsëriti përfundimet e saj në çështjen Driza dhe i bëri thirrje Shtetit të paditur të miratojë masa të përgjithshme siç tregohen në paragrafin 126 të vendimit në çështjen Driza;
- u shqyrtuan pretendimet në lidhje me nenin 6 [shkelje], nenin 1 të Protokollit Nr. 1 [shkelje] dhe nenin 13 i shqyrtuar në lidhje me nenin 6 [shkelje].

10. Hamzaraj k. Shqipërisë, vendim i 3 shkurtit 2009

- gjykata përsëriti përfundimet e saj në çështjen Ramadhi dhe të tjerë, paragrafët 93 dhe 94;
- u shqyrtuan pretendimet në lidhje me nenin 6 [shkelje], nenin 1 të Protokollit Nr. 1 [shkelje].

11. Nuri k. Shqipërisë, vendim i 3 shkurtit 2009

- gjykata përsëriti përfundimet e saj në çështjen Ramadhi dhe të tjerë, paragrafët 93 dhe 94;
- u shqyrtuan pretendimet në lidhje me nenin 6 [shkelje], nenin 1 të Protokollit Nr. 1 [shkelje].

12. Ramadhi dhe të tjerë k. Shqipërisë, vendim i 13 nëntorit 2007

- u kërkua marrja e masave të përgjithshme për ekzekutimin e vendimit aktual;
- nevojitet një zgjidhje që të siguronte një korrigjim të vërtetë efektiv të shkeljeve të konventës të identifikuar në vendimin e rastit konkret, si dhe në lidhje me të gjitha kërkesat e ngjashme në pritje para saj, në pajtim me parimet e mbrojtjes së të drejtave të parashikuara në nenin 6 § 1, nenin 13 dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1;
- Shteti duhet të caktojë organin kompetent, të përcaktojë rregullat procedurale, të sigurojë përputhshmërinë me rregullat, të heqë të gjitha pengesat për dhënien e kompensimit sipas ligjit mbi pronën;
- masa duhet të përfshijnë miratimin e hartave për vlerësimin e pronës në lidhje me ata kërkues që kanë të drejtë të marrin kompensim në natyrë dhe përcaktimin e një fondi të përshtatshëm në lidhje me ata kërkues që kanë të drejtë të marrin kompensim në para, në mënyrë që të bëhet e mundur për të gjithë kërkuesit që kanë vendime të komisionit në favor të tyre për të marrë shpejt tokat apo shumat përkatëse;
- marrja e këtyre masave duhet konsideruar si një çështje urgjente;
- u shqyrtuan pretendimet në lidhje me nenin 6 [shkelje], nenin 1 të Protokollit Nr. 1 [shkelje] dhe nenin 13 i shqyrtuar në lidhje me nenin 6 [shkelje].

ENI 80 I RREGULLORES- KËRKESA PËR RISHIKIMIN E NJË VENDIMI

1. Në rast të zbulimit të një fakti që nga natyra e tij ka një ndikim përcaktues dhe që në momentin e dhënies së vendimit nuk ishte në dijeninë e Gjykatës dhe që nuk mund të ishte logjikisht i ditur as për njërin nga palët, kjo e fundit brenda një periudhe prej gjashtë muajsh nga momenti i ardhjes në dijeni mund t'i kërkojë Gjykatës që të rishikojë vendimin.
2. Kërkesa duhet të përmendë vendimin që synon të rishikohet dhe duhet të përmbajë të dhënat e nevojshme për të treguar se plotësohen kushtet e parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni. Ajo duhet shoqëruar me një kopje të të gjitha dokumentave ku mbështetet. Kërkesa dhe këto dokumenta mbështetës dorëzohen në Sekretari.
3. Dhoma që e ka shqyrtuar fillimisht çështjen mund të vendosë me nismën e vet që ta refuzojë kërkesën dhe mund të vendosë me nismën e vet për refuzimin e kërkesës me argumentimin se nuk ka arsye për shqyrtim. Kur nuk është e mundur që të krijohet dhoma që e ka shqyrtuar fillimisht çështjen, kryetari i Gjykatës e plotëson ose e krijon dhomën me short.
4. Në qoftë se dhoma nuk e refuzon kërkesën, Sekretari ia bën këtë të njohur palës ose palëve të tjera dhe i fton të paraqesin komente me shkrim brenda një afati të caktuar nga kryetari i dhomës. Nëse dhoma vendos që duhet zhvilluar një seancë, kryetari i dhomës cakton gjithashtu edhe datën e saj. Dhoma mban qëndrim me vendim.

1. Manushaqe Puto dhe të tjerë k. Shqipërisë, vendim i 4 nëntorit 2014

- në lidhje me nenin 6 dhe nenin 13;
- vdekja e vëllait të kërkuesit më pak se një muaj nga dorëzimi i kërkesës;
- kërkuesi nuk e kishte njoftuar gjykatën;
- nuk ishte paraqitur një prokurë përfaqësimi e përditësuar e avokatit;
- Qeveria kërkoi rishikimin e akordimit të dëmshpërblimit në lidhje me dëmin material dhe jo material; vdekja përbën fakt me "ndikim vendimtar" për rezultatin e gjykimit;
- dëmet u zvogëluar.



THE CASE LAW OF THE
EUROPEAN COURT
OF HUMAN RIGHTS WITH
RESPECT TO ALBANIA
UP UNTIL THE END OF 2016

The Republic of Albania

The case-law of the European Court of Human Rights in respect of Albania up until the end of 2016

This document sets out the judgments handed down by the ECtHR in respect of the Republic of Albania, since the State's ratification of the European Convention on 2 October 1996. As of 31 December 2016, the Court has handed down 70 judgments and 62 decisions in respect of Albania.^{1,2}

The document is in two parts. This first part contains a narrative overview of the types of cases in which judgment has been given. The second part contains a table, broken down by Article, listing the cases in which judgment has been rendered with a brief description of the legal issues raised in the case. Some cases appear more than once under the heading of one Article as the Court has found both a violation and a non-violation in respect of that particular Article.

Article 2

2 judgments, *Ceka*³ and *Rrapo*⁴, were delivered on Article 2 against Albania. The first case was struck out as the Court decided that the applicants had been given a full remedy in domestic law, as the State had clearly acknowledged the breach and paid adequate compensation.⁵ In the second case, no violation was found.⁶ The case concerned the extradition of the applicant. The diplomatic note that had been offered was found to contain sufficient assurances that no violation of the right to life would occur upon extradition.

Article 3

